



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

-Miratimi i procesverbalit të datës 14 nëntor 2019.

1. Diskutimi në parim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", *komision pergjegjes*.
2. Diskutimi në parim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë i projektligjit: "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli i Ministrave, *komision për dhënie mendimi*.
3. Seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe AKEP për diskutimin e 2 projektligjeve.
4. Seancë dëgjimore me përfaqësues të medieve audiovizive për diskutimin projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", *komision pergjegjes*.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri dhe Erion Piciri.

Mungojnë:

Fatjona Dhimitri, Enada Kapllani, Amra Barova.

Të ftuar:

Irena Mallolli- drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës,

Enea Karakaci- drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës,

Besmir Beja - drejtor i Pergjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Së pari, faleminderit për durimin! Ju kërkoj ndjesë, por në këto kushte të emergjencës, kemi plot detyra, të cilat na detyrojnë të ushtrojmë presion mbi oraret, prandaj kërkoj ndjesën dhe mirëkuptimin tuaj!

Në fakt, sot kemi një rend dite, i cili ndahet në dy pjesë. Pjesa e dytë është shumë e gjatë, sepse ka të bëjë me prezantime e dëgjesa, por edhe me diskutime nga anëtarët e komisionit.

Pjesa e parë lidhet me miratimin e procesverbalit të datës 14 nëntor. Në qoftë se ju e keni parë procesverbalin, nuk e di nëse keni pasur komente apo jo. Në qoftë se nuk keni arritur ta shihni, unë besoj se tashmë secili nga ju e di rregullin që kemi vendosur në këtë komision: që rishikimet e fundit që secili mund të ketë për procesverbalin, depozitohen me shkrim pranë sekretarisë.

Çështja e dytë e rendit të ditës lidhet me diskutimin në parim për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 97/2013, “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9918, dt. 19. 5. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Për të parin, ne jemi komisioni përgjegjës, ndërsa për të dytin jemi komision për dhënie mendimi.

Ne kemi të ftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe nga Ministria e Drejtësisë. Kemi këtu zonjën Irena Mallolli dhe zotin Enea Karakaçi, të cilët vijnë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe zotin Besmir Beja, i cili vjen nga Ministria e Drejtësisë, nga Drejtoria e Kodifikimit.

A janë këtu tre përfaqësuesit? Në rregull!

A mund të filloni me një shpjegim të projektligjeve, sipas detyrave që keni? Kush do ta marrë fjalën? Para se të merrni fjalën, desha t’I drjetoheja sekretarit të komisionit, zotit Ylli, që të na e thotë se si jemi me kuorumin në komision.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë, kështu që ne mund ta vijojmë normalisht mbledhjen e komisionit.

Milva Ekonomi – Fjala është për juve, që jeni të ftuar.

Besmir Baja – Faleminderit, zonja kryetare!

Është kënaqësi të jem këtu, para jush, për të shpjeguar nismën që ka ndërmarrë Këshilli i Ministrave në lidhje me atë që është quajtur “Paketa antishpifje”, ose ndryshime në ligjin për mediet audiovizive dhe AKEP-in.

Duke pasur në konsideratë pozitën e gazetarëve dhe të medias në tërësi, sikurse dhe rolin e tyre në kuadër të lirisë së shprehjes, dhënies së informacionit në interes të publikut në raport me influencën e portaleve *online* gjatë viteve të fundit në vendin tonë, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka ndërmarrë nismën ligjore me qëllim amendimin e ligjeve aktualisht në fuqi në fushën e komunikimeve elektronike dhe medieve audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Sjellim në vëmendje faktin e disa prej problematikave të konstatuara, të cilat kanë diktuar nevojën për ushtrimin e iniciativës legjislative përkatëse në drejtim të paketës antishpifje, që konsistojnë si më poshtë:

Së pari, ka mungesë të një rregullimi shterues lidhur me veprimtarinë e ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike. Mediet elektronike kanë një trend në rritje, duke shmangur dhe zëvendësuar mediet tradicionale, për shkak edhe të lehtësisë së aksesit të çdo individi dhe mundësisë së përdorimit të portaleve online nga një numër i pakufizuar personash.

Së dyti, për pos faktit se ofruesit e shërbimit të publikimeve online nuk ofrojnë akses për paraqitjen e ankesave të mundshme, në legjislacionin aktual në fuqi nuk ka qartësisht sanksione ligjore lidhur me mosrespektimin e detyrimeve përkatëse, sa i përket kufizimit të publikimeve të përmbajtjeve të paligjshme apo të dëmshme.

Së treti, për shkak të zhvillimeve të vazhdueshme të teknologjisë së informacionit, gjatë viteve të fundit është vënë re një tendencë në rritje sa i përket publikimit online të materialeve me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme.

Nevoja për ta rregulluar këtë fushë, e cila deri më sot është plotësisht e parregulluar, ka lindur edhe nga roli e ndikimi që ka media elektronik në një shoqëri demokratike.

Siç dhe jeni në dijeni, fushatat keqinformuese ose *fake news*, kanë ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimet politike të një vendi, veçanërisht gjatë referendumeve ose zgjedhjeve. Sipas *Freedom House*, manipulimi online dhe taktikat e keqinformimit kanë luajtur një rol të paktën në 18 vende të ndryshme.

Nga ana tjetër, lajmi i rremë është shndërruar, jo vetëm në Shqipëri, në një instrument përmes të cilit gjenerohen të ardhura. Kjo është arsyeja që edhe në planin e veprimit të Komisionit

European, në lidhje me keqinformimin, i datës 5 dhjetor 2018, keqinformimi është përkufizuar si shpërndarje e informacioneve të rreme e çorientuese, me qëllim përfitimin ekonomik apo për të mashtruar publikun qëllimisht. Për më tepër, lajmi i rremë delegjtimon zërin e ekspertizës, cilësinë e gazetarëve të bazuar te faktet e të dhënat, si dhe prek aftësinë e publikut për t'u angazhuar në diskurse të bazuara në fakte.

Gjithashtu, vlen të theksohet se në ndryshimet e propozuara, ky projektligj nuk cenon në asnjë dispozitë të tij lirinë e shprehjes dhe pluralizmit të tregut të medias audiovizuale apo elektronike, por synon përcaktimin e disa rregullave dhe vendosjen e disa standardeve etike, në mënyrë që të respektohet dinjiteti e të drejtat themelore të njeriut, si dhe të përmirësohet cilësia e informimit dhe e diskursit publik.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë studiuar legjislacionet dhe modelet e shteteve të tjera, si Gjermania, Mali i Zi, Letonia, Kroacia, dhe është konstatuar se rregullimi i përmbajtjes së publikimeve elektronike është normuar me ligj edhe në këto shtete. Si shembull mund të përmendim ligjin kroat, i cili rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave juridikë e fizikë, të cilët ofrojnë shërbime mediatike audio e audiovizuale, dhe shërbime të publikimeve elektronike nga rrjetet e komunikimit elektronik.

Gjatë fazës së hartimit, këto akte janë konsultuar gjerësisht me palët e interesuara, duke zhvilluar të paktën katër tryeza konsultimi me palët e interesit. Gjithashtu, në hartimin e tyre është dhënë asistencë edhe nga zyra e OSBE-së për lirinë e medias. Së fundmi, është punuar edhe me Komisionin e Ligjeve në lidhje me përmirësimin e këtyre drafteve, në përputhje me rekomandimet që ka dhënë zyra e OSBE-së në lidhje me këtë çështje.

Ju faleminderit!

Milva Ekonomi – Ka gjë tjetër për të shtuar ndokush nga ju?

Para se të kalojmë tek pyetjet nga ana e anëtarëve të komisionit, unë do të ndalesha në një çështje tjetër, e cila ka të bëjë me ata që do të jenë relatorë të këtij ligji. Nga anëtarët e komisionit që janë pjesë e grupit të Partisë Socialiste, do të jenë dy relatorë: zoti Ulqini dhe unë. Nga pala tjetër do jetë zoti Erion dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm Fatjona? Mua më ka ardhur mesazhi se do të jeni të dy! Në rregull!

Kjo ishte, që të kemi parasysh edhe se si do të vazhdojë më tutje përgatitja e raportit. Të gjithë anëtarët e komisionit, që kanë nevojë të bëjnë pyetje për këta që janë hartuesit e parë, mund

t'i bëjnë. Ndërkohë, ne në komision jemi njohur me materialin që ka ardhur nga zyra e OSBE-së, në lidhje me të gjitha vëzhgimet që ata kanë bërë që nga fillimi i këtij procesi e deri në fund, të gjitha raportet e vëzhgimit. Po ashtu, kemi edhe amendimin final, që ata kanë bërë, pjesë e dosjes së këtij diskutimi të këtyre dy projektligjeve.

Kolegë deputetë, ju ftoj të hapim seancën e pyetjeve. Kush ka pyetje për prezantuesit e projektligjeve?

Halit Valteri – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Unë kam dy pyetje. A e cenon lirinë e medieve ky projektligj? Ka pasur mjaft kontestime për këtë projektligj, lidhur me mbifuqizimin e kompetencave të AMA-s, të cilat mund të çojnë në kthimin si mjete respektive ndaj medieve të caktuara. Cili është qëndrimi juaj?

Faleminderit!

Milva Ekonomi – T'i mbledhim të gjitha pyetjet? Kush ka pyetje tjetër?

Ta mbarojmë seancën e pyetjeve? Të vazhdojmë me diskutimet, nëse ka njeri që dëshiron të diskutojë?

Në rregull! Atëherë, cili nga ju do t'u përgjigjet këtyre dy pyetjeve?

Besmir Beja – Në vlerësimin tonë, siç u parashtrua edhe gjatë shpjegimit, ligji është në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Është një ligj që lejon pluralizmin e medias në një shoqëri demokratike dhe krijon një balancë të përshtatshme mes mbrojtjes së interesit të individit dhe lirisë së medias. Pra, nuk e cenon në asnjë mënyrë lirinë e medias.

Edhe në raport me AMA-n, zgjidhja që është gjetur, është një zgjidhje e cila bën neutral instrumentin përkundrejt medias, që do të thotë: të njëjtët instrumente që ka AMA kundrejt medieve tradicionale, janë zgjatuar edhe kundrejt medieve të tjera, që janë online. Pra, pavarësisht formës së medieve, ndaj tyre është kryer i njëjti rregullim.

Milva Ekonomi – Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit për prezantimin!

Do të doja të dija pak më shumë në lidhje me momentin e marrjes së iniciativës për të bërë të tilla ndryshime. Cilat janë modelet europiane, që u jeni referuar, për të qenë jo vetëm të përafruar me vendet e tjera të Bashkimit Europian, por edhe për të përfutur nga eksperiencat më të mira në lidhje me këtë fushë? Sepse *fake news* ose informacionet e rreme nuk janë shqiptare dhe as nuk e kemi shpikur ne termin. Ka disa vite që e dëgjojmë këtë shqetësim në të gjitha mediet botërore, në

shumë medie të tjerë. Po ashtu, e dimë edhe si ka ndikuar negativisht ky lloj fenomeni, që bashkëshoqëron zhvillimin e teknologjisë, jo vetëm në procese politike, por edhe në zhvillime të ndryshme sociale, të cilat pastaj sjellin pasoja negative qoftë në zhvillimin ekonomik, qoftë në zhvillimin dhe emancipimin e shoqërive të ndryshme. Pra, nuk po shpikim rrotën. Le të themi, jemi duke e bashkëvuajtur këtë fenomen, i cili mund të përballet vetëm duke u rregulluar dhe duke u kontrolluar nëpërmjet mekanizmave ligjorë. Në këtë kuptim, për ne do të ishte me interes të dinim diçka në lidhje me modelet e tjera me të cilat jeni konsultuar në hartimin e këtij draftligji. Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë lidhet me rekomandimet e fundit të bëra nga ana e ekspertit të OSBE-së, bërë publik dje, por më sa di është hartuar disa javë më parë. Në atë raportim që lexova dje në faqen e OSBE-së, por lexova gjithashtu me kënaqësi në prononcimin e zotit Harlem Desir, që ka një proces të gjatë konsultimesh midis ekspertëve të OSBE-së dhe grupit hartues, konsultime të cilat kanë sjellë, po citoj këtu fjalët e zotit Desir: një përmirësim të dukshëm, të kënaqshëm, të pranueshëm, siç e kuptova unë, të pranueshëm edhe nga OSBE-ja.

A janë reflektuar këto në draftin final, që ne kemi, pra, të gjitha rekomandimet dhe amendimet e propozuara nga OSBE?

Këto janë dy pyetjet e mia për momentin.

Besmir Beja – Sa u përket modeleve, ka një sërë instrumentesh ndërkombëtare, të cilat garantojnë mënyrën se si mundet dhe duhet rregulluar fusha e medias, veçanërisht ajo me qasje elektronike. Në bashkëpunim edhe me ekspertët ndërkombëtarë, veçanërisht ata të zyrës së OSBE-së, është punuar ngushtësisht në lidhje me përmirësimin e drafteve fillestare, të cilat kanë pasur si bazë legjislationin e Gjermanisë, të Malit të Zi, të Letonisë dhe të Kroacisë, por kryesisht atë të Kroacisë. Kroacia e ka rregulluar në mënyrë shteruese, në përputhje me praktikat ndërkombëtare, në përputhje me legjislationin e Bashkimit Europian. Ajo ka qenë nisma fillestare, ku ne jemi bazuar për hartimin e ligjit.

Më pas, gjatë konsultimit me grupet e interesit dhe me ekspertët ndërkombëtarë, është përmirësuar dhe janë marrë në konsideratë të gjitha argumentet e paraqitura, veçanërisht ato të ekspertëve ndërkombëtarë. Çështjet e fundit mund të vijnë edhe për shkakun se ato çështje gjejnë rregullime në ligje të tjera, ndaj jo domosdoshmërisht duhen rregulluar në këtë ligj. Pra, kryesisht janë çështje të teknikës legjislative, në vlerësimin tim, por është mbajtur në konsideratë çdo koment thelbësor, i cili mund të ndikonte ose dukej sikur mund të ndikonte në lirinë e medias.

Faleminderit!

Kostaq Papa – Faleminderit! Përshëndetje!

Qëkurse ka filluar problematika e ligjit për medien dhe komunikimin elektronik, po bëhet një zhurmë e madhe, e cila ka të bëjë me aspekte të ndryshme të përdorimit të fuqisë së ligjit në mediet dhe informimin publik. Kësaj zhurmë, që pa dyshim ka efektet dhe elementet e saj, si i përgjigjeni ju, për t'i dhënë asaj efektin e kundërt, nëse ju keni të drejtë në këtë imponim të ligjit?

Pyetja e dytë: në nenin 4 të ligjit për medien, AMA shndërrohet në AMSH, por në nenet e mëposhtme rikthehet prapë në AMA. Po kështu edhe bordet. Si do të veprojmë? Do ta mbajmë AMA apo AMSH? Do të themi AMA-Autoriteti i Medieve Audiovizive apo Autoriteti i Medieve Shqiptare? Po kështu edhe për bordet. Cili nga këto emërtesa do të mbahet?

Shikoni, se ka edhe gabime të tjera teknike në projektligjin që kemi përpara.

Faleminderit!

Besmir Beja – Në lidhje me pyetjen e parë, nëse e kuptova drejt, se përse ekziston një zhurmë e tillë mediatike kundrejt kësaj nisme...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk di të jap ndonjë përgjigje në lidhje me këtë çështje. Ajo që unë do të këshilloja, është leximi me kujdes i dispozitave që ne kemi propozuar ose, më saktë, versionit më të fundit, hartuar në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë. Në vlerësimin tonë, besoj se edhe në vlerësimin e ekspertëve ndërkombëtarë, gjendja e aktit ose e dy akteve që janë tani, është plotësisht në përputhje me praktikat ndërkombëtare. Për çfarëdo shqetësimi që mund të kenë pasur mediet, besoj se i kemi adresuar këto ndryshime e propozime të reja që kanë ardhur.

Besoj se ky është një shqetësim që mund të tejkalohet, në rast se vlerësohet drafti i fundit që është përcjellë. Sa u takon çështjeve që lidhen me teknikën legjislative, patjetër që do të rregullohen me shumë kujdes. Në lidhje me emrin, pavarësisht se është ndryshuar në Autoriteti i Medieve Shqiptare, akronimi ka mbetur përsëri AMA, për të mos ndërhyrë shpesh, ngase vjen edhe nga anglishtja: Albanian Media Authority.

Sigurisht, nëse ka çështje të teknikës, të cilat mund të përmirësohen dhe ndryshohen, patjetër që mund të bëhet. Ju jeni krejtësisht kompetentë për ta bërë këtë.

Milva Ekonomi – Ismet, doje fjalën?

Ismet Beqiraj – Diskutimin e sotëm të kësaj pakete të antishpifjes, që ka të bëjë me dy ligjet bazë, unë do ta quaja një masë parandaluese të tërmetit mediatik, që ndodh zakonisht në

mjedisin shqiptar. Ashtu si edhe në shkencat e tjera teknike merren masa parandaluese, të veshura me akte ligjore e nënligjore, pse të mos bëhet edhe këtu?

Në vijim, do të bëj disa pyetje, ju lutem, lidhur me draftin final. Ndonëse ka një shqetësim prapë nga përfaqësuesit e OSBE-së, lidhur me përcaktimin më të qartë kudo në ligj, të togfjalëshit “shërbimet mbështetëse”, në draftin final ju e keni prezantuar këtë.

Kam pyetje të tjera në lidhje me detyrimet e operatorit të shërbimit publik elektronik, ku është hequr nga propozimi final pika 2 e shtesës tek neni 31/1, ku thuhet: “një ofrues i shërbimeve publike elektronike duhet të respektojë privatësinë e dinjitetin qytetar dhe të mbrojë integritetin e të miturve”. Pse është hequr kjo? Ku cenohet liria e medias në këtë aspekt, sepse nuk jepet e qartë?

Përsëri këtu, lidhur me identifikimin, regjistrimi i ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike. Thuhet: “Një person fizik a juridik, i cili ofron shërbime të publikimeve elektronike, mund të aplikojë tek AMA për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të tij në regjistrin e ofruesve të shërbimit mediatik . Ky identifikim nuk është parakusht për të ofruar shërbimin.”

Pse përdoret fjala “mund”? Domethënë, lihet prapë në dorë të ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike dhe AMA pastaj të vijë vërdallë që t’i gjejë këta.

Pyetja e tretë, neni 23 i draftit, në nenin 37/1, lidhur me regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike, në pikën 4, thuhet: “Ofruesit e shërbimeve mediatike që nuk janë regjistruar në këtë regjister ose nuk i kanë përditësuar të dhënat në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AMA, nuk do të përfitojnë lehtësira fiskale apo të ndonjë lloji tjetër”. Po aktivitetin do ta zhvillojnë? Sikur janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Milva Ekonomi – Dakord.

Besmir Beja - Për sa i përket pyetjes së parë që lidhet me një koment që eksperti i OSBE-së vijon ta ketë në raportin e tij, që lidhet me shërbimet mbështetëse: a duhet të vihet në dukje që në gjendjen që është aktualisht ligji për AMA-n i ka të përcaktuara shërbimet mbështetëse? Nuk është një risi që është sjellë nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje. Mënyra se si është formuluar, fusha e zbatimit, nëse më lejoni ta lexoj, neni 2, thotë: “Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre”. Pra, nuk është një çështje të cilën e kemi propozuar rishtas me këtë projektligj, por është një çështje ekzistuese në ligjin për AMA-n. Shërbimet mbështetëse lidhen me transmetimet lineare dhe audiovizive dhe jo me transmetimet elektronike, me platformat *online*. Mund të ketë

qenë edhe çështje përkthimi, mund ta ketë kuptuar sikur shërbimet mbështetëse lidhen edhe me këtë, por në fakt ligji aktual i AMA-s e ka të parashikuar si term.

Ndryshimet që i janë bërë projektligjit nga versionin fillestar i propozuar në versionin aktual që po shqyrtojmë, lidhen me punën që është bërë me ekspertin për të adresuar çdo shqetësim që kishte ai në lidhje me gjuhën e përdorur apo me mundësinë që mund të keqpërdorej gjuha e vendosur në projektligj për të përkufizuar lirinë e medias në Shqipëri. Për këtë shkak, pavarësisht se në vlerësimin tonë fillestar gjuha ishte mjaftueshëm neutrale, për të mos lejuar asnjë lloj keqpërdorimi, me kërkesën e ekspertit është hequr. Janë vendosur vetëm ato dispozita, të cilat nuk mund të lejojnë asnjë lloj forme të keqpërdorimit të tyre në të ardhmen.

Për çështjen e regjistrimit ka pasur diskutime të gjata, asnjëherë nuk ka qenë regjistrimi si kusht i portaleve elektronike ose i medias si kusht për të transmetuar ose për të funksionuar si medie. Tashmë regjistri i ofruesve të shërbimeve elektronike është vetëm një regjistër identifikues. Mediet elektronike mund të zgjedhin ose jo, është zgjedhja e tyre, për t'u regjistruar në këtë regjistër. Por nuk është i detyrueshëm ofrimi i shërbimeve mediatike regjistrimi në këtë regjistër. Ajo që zgjidhin është përfitimi i lehtësirave fiskale ose lehtësirave të tjera, në rast se janë të regjistruar në këtë regjistër. Pra, është një zgjidhje e tyre, ndihmon AMA-n në punën e saj, nëse regjistrohen duke pasur një ide të qartë se cilat janë të gjitha platformat elektronike, mediatike që ofrojnë këto lloj shërbimesh, por, nga ana tjetër, nuk është një kusht i detyrueshëm dhe në këtë kuptim nuk cenon në asnjë mënyrë ligjin për mediet.

Milva Ekonomi - Faleminderit! Ka pyetje të tjera?

Ismet Beqiraj – Pyetja e tretë, veprimet e AMA-s, dua të përdor në fakt fjalën represive, a nuk ju duken autokrate nëse ato nuk apelojnë? Kemi një mungesë apelimi për vendimet që do të marrë në mënyrë abuzive AMA. Është bërë ndryshimi në materialin e fundit? Zhurma më shumë për këtë është bërë.

Besmir Beja - Ndryshimet edhe në vijim të rekomandimit të ekspertit janë kryer në projektligj, por në çdo rast duhet të vihet në dukje se pavarësisht përcaktimit të shprehur në projektligj, kuadri ligjor në Shqipëri e bën të mundur, krijon aftësinë për çdo lloj vendimi të administratës publike për ta kundërshtuar në gjykatë. Nuk ka asnjë vendim të administratës apo të individit që t'i mohohet aksesit në gjykatë përkundërt një veprimi apo mosveprimi të administratës publike. Legjislacioni aktual në fuqi, ligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ashtu si edhe Kodi për Procedurat Administrative e kanë parashikuar shprehimisht

të drejtën e ankimit në gjykatë kundrejt veprimeve apo mosveprimeve të administratës publike. Sidoqoftë, për të shteruar ose për të hequr çdo lloj shqetësimi që mund të kishte eksperti në raport me ligjin e AMA-s, është parashikuar shprehimisht e drejta e ankimit në gjykatë si ndaj vendimeve të këshillit, ashtu dhe ndaj vendimeve përfundimtare të bordit.

Milva Ekonomi - Ka pyetje?

Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini - Faleminderit, zonja kryetare!

Unë i ndoqa me shumë vëmendje të gjitha shpjegimet paraprake që u dhanë këtu. Mendoj se është me vend të bëj një vërejtje miqësore për përfaqësuesit e qeverisë lidhur me shpjegimin që dhanë këtu, sepse ai është shumë larg shpjegimit shumë të plotë që është dhënë në një dokument që e kemi përpara, i cili ka ardhur nga qeveria, ku shpjegohen shumë qartë arsyet se pse u ndërмор kjo nismë. Kjo është shumë e rëndësishme. Në dokumentin në fjalë thuhet shumë qartë:

1. Faqet *online* të respektojnë thelbin e medias, që është informimi, argëtimi dhe edukimi i publikut.

2. Të garantohet e drejta e informimit dhe e lirisë së shprehjes, dhe jepen argumentet.

3. Të mbrohet dinjiteti dhe liritë themelore të njeriut, që janë shumë të rëndësishme.

4. Të respektohet dhe të garantohet e drejta e ruajtjes së jetës private.

Ne kemi një ligj për këtë dhe të gjithë janë të detyruar që të respektojnë këtë gjë.

5. Të mos lejohen publikimet që nxitin dhunën, gjuhën e urrejtjes dhe lajmet e rreme.

Ky është standard i OKB-së, i BE-së dhe i të gjithë organizmave që merren dhe monitorojnë çështjet e medieve.

6. Të respektohet dhe të mbrohet e drejta e autorit, një problem shumë i madh në Shqipëri. Në dokumentin në fjalë, që ka paraqitur qeveria, janë shpjeguar shumë qartë. Pse e them këtë? Sepse ky projektligj ka ngjallur shumë debat dhe shumë diskutime. Ky debat dhe këto diskutime i kanë shërbyer përmirësimit të projektit. Kjo është një gjë shumë e mirë, por ka pasur dhe shumë të pavërteta dhe përfaqësuesit e qeverisë përveçse duhet të shpjegojnë me argumente arsyet pse është ndërmarrë nisma dhe çfarë sjell ajo, duhet të shpjegojnë pak më gjatë edhe debatin që është bërë për këtë projekt, sepse ka vërtet pasaktësi. Thuhet sikur është një projekt i bërë diku në errësirë, që ka kaluar menjëherë, pa debate, pa diskutime.

Unë dua të informoj mediet që janë këtu se kjo nuk është e vërtetë, pasi që nga dhjetori i vitit 2018 ka kaluar një vit që ky projekt është duke u diskutuar. Kjo nuk është një nismë e komisionit tonë, por e qeverisë. Qeveria ka 1 vit që ka diskutuar për këtë projektligj, janë bërë 4 tryeza me ekspertë shqiptarë dhe ndërkombëtarë, është marrë në konsideratë shumëçka është thënë nga zyra e OSBE-së për mediet në Vjenë. Kryeministri, Edi Rama, ka pritur përfaqësues të disa organizatave ndërkombëtare në qershor për këtë gjë. Propozimet e tyre janë mbajtur shënim. Është bërë një seancë dëgjimore në Komisionin e Ligjeve në datën 25. Për herë të parë ne fillojmë sot këtë diskutim. Kemi planifikuar të ftojme të gjithë grupet e interesit, shoqatat, organizatat ndërkombëtare që monitorojnë mediet në Shqipëri, si dhe përfaqësuesit e qeverisë që kanë paraqitur projektin. Është një debat që do ta bëjmë sot dhe disa ditë me radhë. Kjo tregon se çështja është sensitive, është shumë e rëndësishme që të ketë informacion sa më të gjerë për arsyet, të mirat që sjell projekti, sepse askush nuk ka guxuar dhe nuk guxon të ndërmarrë një nismë ligjore, sidomos në fushën që rregullon mediet, që të cenojë sadopak liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, lirinë e informimit; janë gjëra që janë të sanksionuara në Kushtetutë. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar të gjitha konventat e OKB-së, si dhe dokumente të tjera, siç është Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, që i kemi miratuar dhe i kemi përkthyer në të gjithë legjislacionin tonë. Ishte një shpjegim i panevojshëm për ne anëtarët e komisionit, por i nevojshëm për mediet që e ndjekin këtë diskutim dhe jam besimplotë që në praktikën më të mirë të këtij komisioni, të gjitha këto seanca dëgjimore nuk i bëjmë formalisht, por me seriozitet maksimal, pra, do t'i dëgjojmë me vëmendje, do të vazhdojmë ta përmirësojmë projektin.

Unë lexova me vëmendje se çfarë thuhej dje në një koment të “Zëri i Amerikës” nga përfaqësuesi i OSBE-së në Vjenë, të cilin e njoh, e kam takuar në punën e gjatë në këtë komision. Përfaqësuesit e qeverisë duhet të saktësonin një gjë, sepse nuk është e vërtetë që në projektin që na ka ardhur sot në tavolinë dhe po fillojmë diskutimin, është shmangur gjykata, në mënyrë kategorike. Ajo që thuhet në nenin 132, pika 2 të ligjit në fuqi, është përsëri te projekti në fjalë. Kushdo, në mënyrë të padiskutueshme për çdo vendim të AMA-as ka të drejtë të shkojë në gjykatë. Kjo është një gjë themelore, kushtetuese, është bazike, as nuk mund të mendohet se mund të shmangim të drejtën e kujt do: individ, subjekt e të tjera që, për një çështje me administratën, aq më tepër kur bëhet fjalë për mediet, për AMA-n, të mos ketë të drejtë të shkojë në gjykatë. Solla një shembull për të kuptuar se sa rëndësi ka të jemi të hapur, të japim sa më shumë informacion, të dëgjojmë të gjitha gjërat që thuhet me shumë vëmendje. Këtu nuk ka palë

armiqësore. Të gjitha palët, mendoj unë, edhe ata që e kundërshtojnë, edhe ata që sugjerojnë ndryshime, edhe shqiptarët, ndërkombëtarët, të gjithë kemi një objektiv, që të bëjmë një ligj, ku të shmangim *fake news* që cenojnë kredibilitetin e medieve, por të garantojmë dhe të gjitha të drejtat kushtetuese që i përmenda, që janë nëpër dokumente dhe nuk dua t'i citoj.

Milva Ekonomi - Shume faleminderit, për këtë shpjegim që bërë! Theksove edhe një herë kohën e gjatë që i është dashur këtij projektligji që të vijë përpara këtij komisioni, për t'u diskutuar.

Dua të sjell edhe unë në vëmendje të të gjithë anëtarëve të komisionit, pavarësisht nga forca politike që prezantojmë, pasi ju kujtohet që në projektligjet e fundit, pas dëgjesave, kemi punuar për ndryshimin e projektligjeve nen për nen, sipas opinionëve që na kanë ardhur. Këtë zakon të mirë që ka fituar komisioni, nuk duhet ta humbim edhe për këtë projektligj. Prandaj edhe shkalla e dëgjesave është e shtrirë kaq shumë në kohë, është bërë me kaq shumë grupe interesi, që të gjithë të kenë mundësi të sjellin opinionet e tyre në komision.

Nga ana tjetër, me kohë u jemi përgjigjur kërkesave që kanë bërë një grup gazetarësh dhe një grup shoqatash që vijnë nga fusha e gazetarisë apo e të drejtave të njeriut, ku iu kemi sqaruar se si po ndodh procesi i dëgjesave në komision, procesi i të gjithë veprimtarisë sonë, për sa i përket ligjvënies.

Unë ju bëj thirrje që atë qëndrim të mirë që mbajtem edhe më parë të gjithë bashkë, lidhur me këtë ligj, ta vazhdojmë ta kemi edhe në kohën e këtyre dëgjesave, duke mbajtur shënimet përkatëse dhe duke bërë pyetjet që na duhen për të sqaruar edhe më tepër qëndrimin për këtë projektligj.

Zoti Ulqini, të falënderoj edhe për diçka tjetër, që vure në diskutim përpara nesh, korrespondencën e gjatë që kemi edhe me sekretarinë e komisionit. Ju kujtohet që në kohë të ndryshme kemi marrë materiale të ndryshme lidhur me iniciativën e parë, të dytë, raportet e vlerësimit të punës së grupeve të OSBE-së, raportet përfundimtare, relacionin që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave, por edhe këto ndryshimet, kriteret që plotëson projektligji i ri.

Do t'i kërkoj edhe një herë sekretarisë së komisionit, unë e di që i kemi të gjithë në dosje, të shikojë nëse dosjet janë të plota me të gjitha këto komunikime që kemi pasur.

A ka më pyetje për përfaqësuesit e qeverisë? Ka dikush për të shtuar?

Kostaq Papa - Faleminderit, zonja nënkryetare!

Ajo që doja të thosha, se bëhet zhurmë në lidhje me projektligjin, është në ndikim dhe në dobi të punës që bëjmë. Ne duhet t'i themi medias se duke pasur në dispozicion gjithë këtë kohë për të studiuar dhe ristudiuar gjithçka që ka bërë me këtë ligj, ne do ta bëjmë. Është e domosdoshme, sepse për momentin kemi diçka paradoksale. Kjo e justifikon zhurmën dhe ndikimin që do të japim në lidhje me ligjin, sepse në një vend siç është vendi ynë, për momentin ku shkallët e sistemit shtetëror në të gjitha nivelet janë të kapura nga një maxhorancë, është e domosdoshme fjala jonë, e të gjithë publikut, të mbetet te media. Luftimi i saj apo krijimi i një precedence krijon problematika. Pra, dua të them se me të gjitha shpjegimet që bëri zoti Ulqini, mbetet në vend dhe mbetet e hapur përpjekja jonë për të parë në vazhdimësi çdo moment që ka lidhje me këto ligje, sepse duke e konsideruar si ligji antishpifje, krijohet një precedent që mendoj se e bllokoi përhapjen e së drejtës dhe shkel të drejtën për informim.

Ne që jemi për këtë punë këtu, duhet t'i japim besimin medias dhe pse tek-tuk ndodh që ajo edhe ndaj nesh thotë ndonjë fjalë pozitive apo negative, por nuk duhet ta zbresim nivelin e punës sonë në probleme individuale, por në probleme që kanë të bëjnë me produktin, me asetin publik dhe rëndësinë që ka për shoqërinë.

Milva Ekonomi – Fjalën e ka zonja Kumbaro. Pastaj kalojmë te projektligji tjetër.

Mirela Kumbaro - Për efekt të fjalës që mbetet më shumë në vesh, me të drejtë kolegu foli për zhurmë. Shpeshherë në prodhimin e zhurmës jemi ne dhe shumë si ne, pa dashje në burim edhe për terminologjinë që përdorim. Që të jemi të saktë, jemi komision, jemi ligjvënës, do t'i japim formën finale bashkë me kolegët e Komisionit të Ligjeve. Ky nuk quhet ligj antishpifje. Ky quhet: “Ndryshime në ligjin “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”” dhe projektligji tjetër që diskutojmë është: “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Ky është emërtimi zyrtar i të dyja ligjeve ekzistuese, të cilat është krejt normale që në realitete të reja teknologjike, mediatike, në realitete të reja të komunikimit falë teknologjisë, prodhojnë nevoja për të rregulluar kuadrin e tyre ligjor.

Pasojat që prodhojnë, kur fola për rregullim, janë pikërisht për të shmangur dhe për të parandaluar shpifjet. Biem dakord që janë negative për të parandaluar dhe për të shmangur lajmet e rreme ose *fake news*, të cilat biem të gjithë dakord, janë negative dhe kanë pasoja në shoqëri. I gjithë procesi i gjatë synon ruajtjen e ekuilibrit midis rregullimit ligjor të fenomeneve potenciale negative dhe ruajtjes së asaj që unë e quaj primare: ruajtja e të drejtave dhe e lirisë së shtypit, e medias, e fjalës, e cila është shpeshherë e brishtë dhe një fije e ndan nga abuzimi. Nëse kemi një

proces të gjatë, siç e tha kolegu Ulqini dhe nëse jemi këtu për një tjetër proces, jemi pikërisht për këtë, por t'i japim ligjit emrin që ka, atë që ka pasur, të cilin ne vetëm po e përmirësojmë, falë të gjitha debateve të hapura dhe falë të gjithë ekspertizës ndërkombëtare. Kjo ishte edhe arsyeja pse pyeta pak më parë se cilët janë shembujt që kemi marrë. Më vjen mirë që përveç shembujve të tjerë, është edhe i Kroacisë, që është jo vetëm një vend i BE-së, por është edhe një vend me një realitet shumë afër nesh, duke qenë se bëjmë pjesë të dy në rajonin e Ballkanit.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi në parim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", *komision për dhënie mendimi.*

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri dhe Erion Piciri.

Mungon:

Fatjona Dhimitri, Enada Kapllani, Amra Barova.

Të ftuar:

Irena Mallolli- drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës,

Enea Karakaçi- drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës,

Besmir Beja - drejtor i Pergjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Kush nga ju do të bëjë një prezantim për ndryshimet dhe amendimet që vijnë për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për

komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku ne jemi komision për dhënie mendimi?

Enea Karakaçi - Përshëndetje!

Amendimet e propozuara në ligjin nr. 9918, të vitit 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” kanë vetëm dy nene, dy dispozita që vijnë nga nevoja për të reflektuar të gjitha ndryshimet që u diskutua këtu, në momentin kur të miratohen, si dhe të ligjit nr.97/ 2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me rregullimet dhe shërbimet e publikimeve elektronike, për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social.

Nëse ne do të hapim dispozitat e ligjit përkatës të propozuar këtu, ajo që referohet është bashkëpunimi i AKEP-it me AMA-n për të siguruar zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Medies, të cilat, siç u diskutua më parë, kanë kompetenca të përcaktuara në ligjin e mëparshëm. Në këtë projektligj bëhen disa shtesa për sa u përket kompetencave të AKEP-it, për të zbatuar vendimet e Këshillit të Ankesave.

Milva Ekonomi - A keni tek AKEP-i ndonjë informacion në lidhje me volumin e tregtisë elektronike që është shtuar ose pakësuar në Shqipëri këto kohë?

Enea Karakaçi - Në fakt, unë dhe kolegja ime vijmë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por besoj se AKEP-i do të jetë në komision në orën 11:30 dhe mund t’u japin ata një informacion.

Irena Mallolli - Për sa i përket volumit të tregtisë elektronike, së fundi, ka nga INSTAT-i një publikim për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga familjet dhe nga individët, ku një informacion që përfshihet në këtë publikim është dhe përdorimi i tregtisë elektronike në Shqipëri.

Unë nuk e kam parasysh të saktë shifrën konkrete, por ajo që jepet në rezultatet e vërtetimit është trendi rritës për tregtinë elektronike, një trend global, ku edhe në Shqipëri ndihet vitet e fundit.

Milva Ekonomi - Për të kuptuar influencën që ka media *online* mbi individin, prandaj e bëra këtë pyetje.

A ka pyetje për çështjen e tregtisë elektronike? Ka diskutime?

Kostaq Papa- Po bëj përsëri një ndërhyrje. Kur filluam të kalonim në platformën tjetër të mediave në fillim të shtatorit, u shfaq në ekranet tona një gabim që ka ndodhur nga institucionet e

ndryshme shqiptare, po kam përshtypjen se baza kryesore mund të jetë dogana, por edhe Ministria e Drejtësisë, duhet të ketë ndikimin e saj.

Në aparatet e kodifikuara që kanë ardhur për kalimin në formatin tjetër të kanaleve televizive, thuhej se shkelin filan buton dhe del që jemi në Greqi, pastaj thuhej se kur shkelin Greqinë, dalim në Durrës, nuk ishte ndoshta vetëm për Greqinë. Nga cilado zonë që kanë ardhur këto aparate, nga Greqia, nga Italia, nga Zvicra, kemi një kalim të paligjshëm në Doganë të materialeve të pakontrolluara në pikën nga janë tërhequr, siç bëhet me produktet e tjera që vijnë drejt Shqipërisë. Ky produkt ka ardhur i parregullt dhe në një farë mënyrë përbën shkelje të sovranitetit me mënyrën se si ai ka ardhur i koduar.

Më konkretisht, po ju them se në ekranet tona, kur u mbyllën kanalet në fillim të shtatorit, në disa kanale, që nuk është përgjegjësi e kanaleve, por është e aparaturave të koduara që kanë ardhur, dilte njoftimi se kemi shkelur Greqinë dhe dilte Durrësi në valët audiovizive.

A keni një shpjegim për këtë?

Irena Mallolli – Mendoj që pyetja është posaçërisht teknike dhe lidhet me një proces që monitorohet nga AMA. Në pjesën e dytë të konsultimit që ju keni sot, ka përfaqësues të AMA-s që mund t'ju japin konkretisht përgjigje për çështjen.

Nga ana e ministrisë, si ministri përgjegjëse për politikën e telekomunikacionit, ne kemi ndjekur me vëmendje të gjithë ato procese që kanë ardhur në adresë të ministrisë për çështje të interferencave ndërkufitare.

Kemi bashkëpunuar me të dyja organet rregullatore për zgjidhjen e problemeve rast pas rasti. Në veçanti për produktin e dekoderit mendoj se përfaqësuesit e AMA-s do të japin një përgjigje konkrete.

Faleminderit!

Ismet Beqiraj – Për këto dy projektligje që kanë në thelb shtesa dhe ndryshime të ligjeve që janë në fuqi, të vitit 2008 dhe 2013, është bërë dhe do të bëhet zhurmë mediatike.

Unë kërkoj një sqarim më të hollësishëm në lidhje me këtë projektligj, sepse duket sikur ky projektligj e bën të plotfuqishme AMA-n.

Këtu janë vetëm 4 nene, që bëjnë shtesa dhe ndryshime. Neni i parë ka të bëjë me konceptin dhe me ndryshimet teknologjike, që sigurisht do të shoqërohen edhe me ndryshimet e kornizës së akteve ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me kuptimin, sikurse është në ligjislacionin në fuqi për shërbimet mediatike dhe ofrimi i shërbimit të publikimeve elektronike.

Irena Mallolli – Nëse u referohemi konkretisht propozimeve të ndryshimeve në ligjin nr. 9918 që është ligji “Për komunikimet elektronike”, ndryshimet e para kanë të bëjnë me shtim të përkufizimit të ofruesit të shërbimit të publikimeve elektronike, që praktikisht mungon në ligjin sot dhe duke qenë se ai shtohet te shërbimi për median audiovizive, dhe po të shikohet me kujdes është e lidhur me ofruesin e shërbimeve të publikimeve elektronike që ka përgjegjësi editoriale, pra në analogji me median tradicionale, lihen jashtë shumë publikime elektronike të rrjeteve sociale, që nuk preken nga ky rregullim.

Nëse shohim ligjin nr.97/2013, një nga ndryshimet e rëndësishme është që edhe ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike të respektojnë standardet ndërkombëtare të medias, që janë në nenin 4, që është një nen i hartuar në bashkëpunim me ekspertë të Këshillit të Europës, të OSBE-së, të Komisionit European në fazat e hartimit të ligjit bazë për median audiovizive.

Pjesa ku ndërhyhet është që edhe ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike të respektojnë të njëjtin standard në publikimet e tyre.

Për sa i përket ndërhyrjes te kompetencat e AKEP-it, një formulim që ka të bëjë me administrimin e domeineve është një plotësim i kompetencës aktuale që ka.

Edhe pika e dytë është shtrirë në ligj, por sillet në formë të koncentruar si një pikë shtesë në kompetencat e AKEP-it, te neni 8. Ndërsa dy ndërhyrjet e tjera, siç e shpjegoi kolegu, lidhen me rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional me plotësimet që vijnë të pjesa e ligjit të medias, në mënyrë që ai të jetë i zbatueshëm.

Milva Ekonomi - Faleminderit!

A ka ndonjë tjetër ndërhyrje? Nuk ka.

Atëherë, falënderojmë përfaqësuesit e ministrive dhe vazhdojmë me dëgjesat!

Faleminderit!

Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

3. Seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe AKEP për diskutimin e 2 projektligjeve:
 - projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", *komision pergjegjes*.
 - projektligjit: "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli i Ministrave, *komision për dhënie mendimi*.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri dhe Erion Piciri.

Mungon:

Fatjona Dhimitri, Enada Kapllani, Amra Barova.

Të ftuar:

Jetmir Braha - Drejtor i Autorizimeve në AKEP,

Bleron Dokle – Përfaqësues nga AKEP-I,

Gentian Sala - Kryetar i AMA-s,

Sara Xhumbari - drejtor i Drejtorisë Juridike dhe të Licencave të AMA-s,

Irina Radu – Senior Media Officer nga OSBE,

Elira Canga - National Media Project Officer nga OSBE,
Erkanda Bujari – përfaqësuese e Zyrës së Këshillit të Europës.
Floriana Shkodra – përfaqësuese e PNUD,
Monika Bylaite - Deputy Head of EU Delegation to Albania, përfaqësuese e BE,
Artes Butka – Political Officer – EU Delegation to Albania, përfaqësuese e BE,
Irena Mallolli- drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës,
Enea Karakaci- drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës,
Besmir Beja - drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Monitories:

Kejsi Rizo – përfaqësuese e Avokatit të Popullit,
Eriona Canaj – përfaqësuese e Avokatit të Popullit,

Vijon pika e tretë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Faleminderit të gjithëve që keni ardhur në këtë dëgjese të Komisionit të Edukimit dhe Medias për dy ligje të rëndësishme, që lidhen me veprimtarinë e medieve audiovizive dhe me komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë!

Të ftuar në këtë dëgjese ne kemi përfaqësues nga:

AKEP-i, Bleron Dokle; nga AMA- Gentian Sala, Sara Xhumbari; nga OSBE-ja - Irina Radu – Senior Media Officer, Elira Canga - National Media Project Officer; nga Këshilli i Europës - Erkanda Bujari; nga PNUD-i - Floriana Shkodra; nga BE-ja - Monika Bylaite - Deputy Head of EU Delegation to Albania, Artes Butka – Political Officer, EU Delegation to Albania dhe nga Avokati i Popullit - Kejsi Rizo, Eriona Canaj.

Ju falënderoj shumë që gjetët kohë dhe erdhët të ndanit me ne opinionet tuaja për këto dy projektligje!

Dua t’ju bëj me dije se procesi për këto dy projektligje nuk është një proces i tanishëm, por është një proces i gjatë, i cili daton që nga dhjetori i vitit të kaluar. Që nga dhjetori deri në

fillimshkurtin e këtij viti qeveria ka organizuar katër tryeza të rrumbullakëta me dy ministritë hartuese, të Drejtësisë dhe të Infrastrukturës, për të arritur në këto dy produkte.

Disa nga organizatat tuaja këto gjëra tashmë i njohin, sepse kanë qenë pjesë edhe e dëgjësive dhe në dokumentet që janë depozituar pranë komisionit tonë, të cilat mund t'i gjeni edhe online, parashikohet shumë qartë pse është marrë një iniciativë e tillë, ku ka synuar iniciativa lidhur me shërbimet elektronike dhe se çfarë kanë të bëjnë këto shërbime me atë që quhet e drejta e informimit dhe e lirisë së shprehjes apo të drejtat themelore të njeriut, apo edhe me respektimin e ruajtjes së jetës private dhe garantimin e saj, apo edhe me moslejimin e publikimeve që nxisin dhunën, gjuhën e urrejtjes, lajmin e rremë dhe me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të autorit.

Të gjitha këto janë parë në një këndvështrim të tillë, i cili për kushtet e zhvillimit të juridiksionit në Republikën e Shqipërisë ka kërkuar vazhdimisht të ndajë këto opinione për përmirësime, edhe me ekspertë që vijnë nga organizatat ndërkombëtare.

Prandaj, që në krye të herës i është bërë një informim Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri për Europën, OSBE-së, që të bashkëpunojnë me qeverinë dhe me Komisionin e Ligjeve për të kaluar në një draftligj sa më afër rekomandimeve ndërkombëtare, por duke u nisur edhe nga shembuj të praktikës së mirë të vendeve të BE-së apo të vendeve të rajonit.

Do të donim të dinim mendimin tuaj për variantin final të këtij projektligji.

Ne këtu në komision jemi organizuar për të pasur relatorët tanë përkatës për këtë çështje, që përcaktohen nga dy grupet kryesore politike që ka komisioni, të cilët do të përgatisin raportin e relatimit për ta çuar në seancën plenare.

Gjithashtu, dua t'ju bëj me dije se kuorumi është i plotë. Opinionet që do të keni në këtë seancë dëgjimore, do t'ju luteshim shumë t'i dërgoni edhe me shkrim pranë sekretarisë sonë, sepse eksperiencia e këtyre muajve ka treguar që kur ne ulemi për të përgatitur ndryshimet finale të një projektligji, informacionet tuaja janë shumë të vlefshme.

Gjithashtu, jeni të ftuar të merrni pjesë edhe në dëgjësat që do të vijnë që nga dita e sotme e deri në fund të ditës së premte.

Urdhëroni, zoti Sala!

Gentian Sala – Faleminderit!

Në datën 12 nëntor pranë AMA-s është përcjellë ftesa e Komisionit të Ligjeve dhe në datën 18 nëntor AMA ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë në mbledhjen e bordit. Me 3 vota pro dhe 2 kundër është shprehur kundër në parim për propozimin e ardhur nga Komisioni i Ligjeve.

Kuptohet që AMA është me 7 persona, por për momentin 5 persona janë në AMA.

Shumica e anëtarëve është shprehur se përmes këtij projektligji synohet të eliminohet dhe të censurohet veprimtaria e lirë e medieve online. Sipas këtyre anëtarëve ndryshimet e propozuara e shndërrojnë AMA-n nga një organ rregullator dhe mbikëqyrës të medieve, në një organ prokurorie, si dhe zgjerohet fusha e veprimtarisë së këtij autoriteti.

Ndërsa dy anëtarë, zoti Gjipali dhe unë, u shprehëm parimisht dakord me propozimet, duke qenë se mediat online po zënë një vend gjithnjë e më të madh në hapësirën mediatike shqiptare dhe veprimtaria e tyre duhet të rregullohet nga ana ligjore.

Pra, ky është vendimi i bordit të AMA-s.

Faleminderit!

Bleron Dokle - Faleminderit!

Më lejoni që në emër të AKEP-it të shpreh dakordësinë sa i përket projektpropozimit të dy ministrive për ndryshimet në ligjin nr. 9918, pasi kjo vjen në përputhje edhe me përcaktimet dhe kompetencat e AKPE-it, sipas nenit 15 të po këtij ligji. Pra, AKEP-i është përgjegjës për respektimin e kufizimeve lidhur me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi.

Projektligji është në përputhje edhe me kompetencat e AKEP-it dhe me rolin apo funksionin e tij si organi i vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

Faleminderit!

Irina Radu – Mirëdita!

Faleminderit për të gjitha fjalët e mira që thatë! Unë jam paksa e dëshpëruar, sepse jo të gjitha rekomandimet që ne kemi bërë janë marrë në konsideratë. Duhet gjithsesi të them se ka pasur një përmirësim të dukshëm, sepse, siç e thatë edhe ju zonja kryetare, procesi ka qenë afatgjatë dhe përmirësime ka pasur.

Dëshiroj të jem person pozitiv dhe mendoj se fakti që ky ligj kaloi nëpërmjet institucionit tonë të lirisë së medias, ka bërë të mundur përmirësimet, sepse, përndryshe, kam frikë se do të kishte mbetur ashtu siç u paraqit.

Falë faktit që ligji kaloi pranë institucionit të Lirisë së Medieve, ne patëm përmirësime të dukshme dhe kjo u vu në dukje edhe dje nga zoti Nezie. U përgëzuan konsultimet e shumta që u bënë në kandër të këtij ligji. Gjithashtu, ai shprehu bindjen dhe optimizmin e tij se ligji do të ecë

përpara në mënyrën e duhur, megjithatë ai ka ngritur një sërë çështjesh që do të doja t'i nënvizoja këtu.

Një nga gjërat që u vu në dukje edhe dje është fakti që AMA-s duhet t'i jepen kompetenca të mirëpërcaktuara, të qarta, sepse kjo do të ishte në të mirë edhe të punës që do të bëjë AMA në të ardhmen.

Gjithashtu, ne kemi pasur një opinion edhe për përmasat e gjobave që vendosen. Ato na duken tejet të larta, sepse gjobat duhet të jenë proporcionale në raport me veprën që kryen autori i shkrimit.

Një gjë tjetër shumë e rëndësishme është që duhet të ndajmë kritikën e politikave apo për arsye politike nga ajo që quhet “shpifje”.

Gjithsesi, duke thënë të gjitha këto, duam të ruajmë frymën pozitive të ecurisë së ligjit.

Pa dashur t'ju marr shumë kohë, dua t'ju them se opinioni ligjor dhe një komunikatë për shtyp gjenden në faqen e internetit të institucionit *Freedom of Media*. Ne duam të shohim shumë përmirësime në këtë ligj dhe mendoj se është koha jo vetëm për ato dy gjëra që ju përmenda më sipër, por të përqendrohemi më shumë jo vetëm tek ajo që është kthyer në një problem, përqendrimi i pronësisë së medieve, sepse kjo ka lidhje të drejtpërdrejt me lirinë e shprehjes. Besoj se të gjithë e keni lexuar raportin e ODIHR-it për zgjedhjet e fundit, në të cilin është vënë në dukje edhe çështja e pronësisë tejet e përqendruar e medieve.

Ne duam që gjithçka në këtë vend të jetë e lirë. Ndërkohë jemi të shqetësuar për kasetat e gatshme të regjistruara që u jepen medieve dhe të paktën në këto raste duhet të shfaqen me titra që kasetat janë marrë të gatshme.

Do të doja që sot t'ju uroja me plot gojën, por ende mbetemi në pritje të përmirësimeve të tjera të mëtejshme, pavarësisht që ligji ka përmirësime të dukshme nga versioni i parë që na është paraqitur.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Kush do ta marrë fjalën për Këshillin e Europës?

Zonja Bujari

Erkanda Bujari – Faleminderit!

Faleminderit që jeni konsultuar me ne dhe që na bëni pjesë vazhdimisht të konsultimeve tuaja!

Në fakt, kjo është seanca e dytë dëgjimore në të cilën marrim pjesë, pasi e para ka qenë e datës 25 nëntor, në të cilën janë shprehur qartë edhe mendimet e Komisionit European për gjithë paketën e medias në Komisionin e Ligjeve. Ajo që ne kuptuam nga ky takim, përfshi edhe vetë relatorët, ishte fakti që nuk kishte ndonjë nxitim se përse duheshin çuar më tej këto ndryshime apo amendamente ligjore. Do të ishte edhe në interes të maxhorancës që të kishte një proces konsultimi me të gjithë aktorët kryesorë dhe palët e interesuara, duke marrë parasysh edhe projektin ekzistues me të gjitha parashtrimet dhe komentet përkatëse që janë bërë, natyrisht në të mirë të ligjit, që ky ligj të jetë sa më i mirë. Që prej takimit të datës 25 nëntor mendimi ynë për këtë paketë nuk ka ndryshuar, megjithatë kemi kuptuar, pasi të premtën e shkuar u bë një deklaratë nga Kryeministri i vendit, i cili u shpreh qartë sa i takon qëllimit të objektivit për ta kaluar këtë paketë në seancën plenare të datës 19 dhjetor.

Pyetjet tona janë si më poshtë vijon: Cili është synimi i parlamentit në lidhje me këtë çështje? A do të ketë konsultime të plota? Cilat shqetësime apo komente janë marrë parasysh? A do të krijohen grupe pune? Pra, çdolloj përditësimi që mund të na jepni do të ishte i mirëpritur.

Ashtu siç e tha edhe zonja që drejton mbledhjen, ky proces ka kohë që vazhdon, nuk ka filluar kohët e fundit, që prej dhjetorit me diskutime, të cilat janë bërë në shkurt, pra është një çështje, të cilën si Komisioni European, por edhe delegacioni i Bashkimit European në Tiranë e kanë ndjekur nga afër dhe në vijimësi. Kjo do të thotë që ne kemi bashkëpunuar me autoritetet shqiptare në lidhje me këtë çështje ose dosje, siç e quajmë ne, dhe Komisioni European ka dërguar komentet e tij për projektartimin e parë që u bë në datën 20 shkurt në lidhje me përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara, me direktivën e BE-së për shërbimet e medieve audiovizuale, me direktivën tjetër të BE-së në lidhje me tregtinë, si dhe me politikën në përgjithësi të Komisionit European për të trajtuar çështje që kanë të bëjnë me keqinformimin.

Ne e kemi parë me vëmendje edhe draftin e dytë që na është dërguar në muajin qershor të këtij viti dhe jemi shprehur në lidhje me shqetësimet e mëparshme, ato më kryesoret, me përputhshmërinë e tyre me legjislacionin e Bashkimit European në veçanti, të cilat me aq sa u pa ishin adresuar në versionin e rishikuar. Megjithatë, kemi theksuar që duhet të ketë përputhshmëri ose pajtueshmëri të plotë të projektligjit me të gjitha ato standarde apo kërkesa për lirinë e shprehjes dhe të fjalës, të cilat ende nuk janë trajtuar.

Ashtu siç e kemi thënë edhe në komentet tona të mëparshme, madje edhe në deklaratat publike që kemi bërë, ndajmë të njëjtat shqetësime si edhe ju për autoritetet shqiptare në lidhje me

çështjen e dezinformimit, megjithatë Komisioni European vazhdon të rekomandojë qasje, të cilat duhet të jenë më pak të ashpra dhe të bazuara në qasjen e vetërregullimit.

Në lidhje me projektpaketën që do të analizoni sërish sot, kemi shqetësime të përafërta me ato të dy javëve më parë, të cilat janë ngritur nga të gjitha organizatat ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë. Shqetësimet tona i kemi ndarë edhe me OSBE-në, ndërmjet organizatave të tjera. Gjithashtu, me anë të fondeve të Bashkimit European u mobilizuam edhe për një ekspertizë tjetër të Këshillit të Europës, në mënyrë që ata ta rishohin këtë paketë legislative, e cila i është ofruar Komisionit të Ligjeve që para 2 javësh. Më lejoni që për të gjitha këto gjëra që ju përmenda më lart, t'ju bëjmë thirrje juve, Kuvendit të Shqipërisë, që të përfitoni sa më shumë të jetë e mundur nga kjo ekspertizë. Të gjitha këto ndryshime që mendohen të bëhen janë dërguar nga ana jonë në Bruksel, në selinë tonë qendrore, po ashtu i kemi ndarë ato me të gjithë kolegët tanë dhe ekspertët në drejtoritë e ndryshme të përgjithshme të Komisionit European, të cilët merren me këto çështje. Natyrisht, ne do to marrim edhe opinionin e tyre në lidhje me këtë draft të tretë, sa më shpejt që ta marrim atë.

Në mbyllje të fjalës time më lejoni t'ju them, që ne i kemi marrë parasysh të gjitha standardet europiane dhe ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes, të lirisë së medias dhe besoj se këto janë absolute kyç për zhvillimin e një medie, që të jetë sa më e fortë dhe pluraliste, që duhet të përbëjë edhe bazën e hartimit të ligjit. Në këtë aspekt e kemi dëgjuar me vëmendje deklaratën e bërë nga ana e përfaqësuesit të OSBE-së për lirinë e medias, po ashtu edhe opinionin e ekspertëve, i cili u nxor ditën e djeshme, si edhe deklaratën e 6 organizatave ndërkombëtare të medias.

Ne dëshirojmë t'i inkurajojmë autoritetet shqiptare, në mënyrë që ato të ndjekin një proces shterues konsultimi me gjithë komunitetin e medias në Shqipëri, duke marrë parasysh gjithë ekspertizën që ekziston dhe të gjitha shqetësimet që janë ngritur. Është tejte e rëndësishme që ky proces konsultimi të bëhet në mënyrën më të mirë të mundshme. Ky proces duhet të jetë themelor dhe i plotë, si dhe të bëhet në mënyrë shteruese, përpara se të kalohet në fazën tjetër, faza e miratimit të ligjit, me synimin apo objektivin e qartë që në të të pasqyrohen komentet, shqetësimet dhe ndryshimet ligjore. T'ju them të drejtën ne nuk mendojmë se kjo gjë do të mund arrihet, sa i takon një ligji kaq të plotë dhe të rëndësishëm, në mënyrën e duhur, deri në fund të këtij viti.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – A ka ndonjë gjë për të shtuar përfaqësuesja e PNUD-it?

Florian Shkodra – Përshëndetje!

Në fakt, më duhet të flas në anglisht, por po flas shqip për arsye të kohës.

Në bashkëpunim me organizatat e BE-së, të Këshillit të Europës dhe OSBE-së si palë shkuam në Komisionin e Ligjeve dhe dhamë disa komente, të cilat ishin specifike sa i takon paketës së ligjeve. Ne, si organizatë e UN-it, e kemi konsultuar këtë paketë ligjesh me zyrën e Komisionerit të Lartë të Drejtave të Njeriut në Gjenevë dhe në bazë të një analize të thellë të të gjitha projektligjeve që na janë paraqitur, siç edhe kolegët e diskutuan këtu, kemi parë një përmirësim shumë të ndjeshëm të draftligjeve nga ato që na u paraqitën në fillim, për këtë arsye ju përgëzojmë. Nga ana tjetër dua t'ju paraqes disa prej shqetësimeve tona në të njëjtën linjë me kolegët e tjerë të tre institucioneve.

Së pari, analiza që u është bërë këtyre ligjeve është bërë në bazë të konventave ndërkombëtare ku Shqipëria aderon, më specifikisht: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Politike, Sociale dhe Civile, e dyta është Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial dhe e treta është Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në bazë të këtyre analizave dhe të komenteve që kemi marrë nga zyra e Komisionerit të Lartë, kemi arritur në tre konkluzione shqetësuese.

Së pari, ashtu siç e përmendi edhe zonja Bylaite, është shumë i rëndësishëm që ligji të krijojë hapësira për një qasje vetërregullimi në të gjitha aspektet. Në këtë kuadër e vlerësojmë si shumë rëndësishme që pjesa që mbulon ligji sa i përket gjuhës së urrejtjes është shumë e drejtë dhe në këtë linjë do ta inkurajonim qeverinë që të krijonte një strategji kombëtare, e cila do të promovonte edukimin si mënyra bazë themelore për parandalimin e gjuhës së urrejtjes. Kjo është sa i takon qeverisë.

Sa i takon rolit të parlamentit në aprovimin e ligjeve, disa artikuj në këto ligje ngrenë shqetësimin sa u takon gjobave, të cilat, ashtu siç e tha edhe kolegja e OSBE-së na duken shumë të larta.

Së dyti, aspekti i ndarjes së kuadrit të marrjes së vendimeve, sa u përket rasteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtës së reputacionit dhe të dinjitetit. Këto janë aspekte që duhet t'u përkasin gjykatave dhe jo institucioneve të tjera.

Së treti, e cila është shqetësuese për ne, është fuqia që përcaktohet në ligj e autoriteteve që kanë të bëjnë me bllokimin e kontentit *online* apo të *uebsitet*-eve. Sipas konventës ndërkombëtare që ju përmenda, për të drejtat politike dhe civile, është shumë e rëndësishme, pasi aty përmendet

që kufizimi i të drejtës së lirisë së shprehjes duhet të përcaktohet me ligj. Në rast se kjo përcaktohet me ligj, rastet në të cilat duhet të përcaktohet ky kufizim është vetëm kur kanë të bëjnë me mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik apo me çështje që kanë të bëjnë me shëndetin publik dhe rendin moral. Në këtë kuadër e vlerësojmë si shumë të rëndësishme që këto tri elemente të merren parasysh kur të shqyrtohen këto projektligje. Nga ana tjetër, kemi disa komente që janë më të detajuara, të cilat do t'ju paraqesim me shkrim. Ashtu siç e ngriti çështjen edhe zonja Bylatite, edhe për ne këto çështje janë të rëndësishme, sidomos për rëndësinë që kanë këto projektligje për interesin publik, kështu që mendojmë se ato duhen të konsultohen në një rang më të gjerë, deri në momentin kur të aprovohen nga parlamenti.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – A ka ndonjë nga përfaqësuesit ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Monika Bylaite – *Flet anglisht.*

Milva Ekonomi – Më falni, a keni përkthyes me vete?

Monika Bylaite – Unë mund të flas shqip, por protokolli e kërkon që të flasë anglisht.

Artes Butka(*përkthen*) - Unë jam përfaqësuese e Këshillit të Europës. Këshilli i Europës në bashkëpunim me Bashkimin Europian ka një projekt shumë të rëndësishëm sa i takon lirisë së medias apo lirisë së fjalës dhe të shprehjes. Ne, si përfaqësues të Këshillit të Europës kemi vite që e ndihmojmë Shqipërinë në lidhje me çështje të rëndësishme, siç është edhe kjo që ka të bëjë me lirinë e medias. Angazhimi dhe mbështetja jonë ka qenë në vazhdimësi, qoftë kjo për kuadrin ligjor të Shqipërisë apo me anën e trajnimeve të ndryshme që kemi bërë me institucione apo organe të ndryshme, të cilat i kemi mbështetur në këtë formë. Disa nga këto institucione kanë qenë Shkolla e Magjistraturës dhe Dhoma e Avokatisë, por ndërkohë e kemi vazhduar mbështetjen tonë me anë të trajnimeve edhe për gazetarët, duke qenë të angazhuar edhe me AMA-n, përfaqësuesit e të cilës janë të pranishëm këtu, si dhe do ta vazhdojmë më tej punën tonë në këtë drejtim.

Në fakt, u ftuam të merrnim pjesë në seancën e mëparshme publike që u organizua nga ju dhe për këtë arsye ne kërkuam edhe ndihmën e një eksperteje shumë të mirë për medien. Ajo ka përgatitur një prezantim të plotë, ishte e pamundur ta sillnim ekspertin të fliste para jush. Ajo ka përgatitur një raport, i cili do t'iu sillet juve me shkrim.

Unë do të ndalem në disa nga rekomandimet e ekspertes në fjalë.

Rekomandimi numër 1 është ky: Duke qenë se përfshirja e medias online, pra e medias joaudiovizive, në formën e bllokimeve elektronike, nuk është në përputhje me standardet e

Këshillit të Europës ose me praktikën e zakonshme europiane, rekomandohet që ligjvënësi t'i lërë mënjatë këto propozime dhe të fillojë hartimin e një strategjie të re në përmirësimin e cilësisë së gazetarisë të asaj online dhe hotline.

Rekomandimi numër 2: Të krijohen mekanizma vetërregullues dhe bashkërregullues, që përfshijnë të gjitha palët e interesuara, në mënyrë që të garantohet parandalimi i përhapjes së përmbajtjeve të dëmshme, të pavërteta ose dezinformimit, që ndër të tjera mund të dëmtojë debatin demokratik në vend, mund të ndërhyjë në integritetin e votës gjatë zgjedhjeve dhe mund të ndikojë tek të drejtat e individëve në shoqëri. Media, gjithashtu, duhet të marrë përgjegjësi dhe të bëhet palë e konventave dhe kodeve të etikës dhe të angazhohet në strukturat vetërregullatore.

Vërehet në veçanti që ndryshimet e propozuara këtu do të krijojnë një regjim veçanërisht të fortë kontrolli të përmbajtjes editoriale për një lloj medieje, përkatësisht asaj elektronike në kontrast kjo me regjimin më të lehtë për transmetimin dhe një regjim vetërregullator për shtypin e shkruar. Kjo do të duket disproporcionale dhe e padrejtë.

Siç u përmend më herët, kur urgjencë më e madhe i jepet menaxhimit të përmbajtjes, që pretendohet se është fyese, në raport me përmbajtjen, që është e dëmshme në lidhje me të miturit, duhet të konsiderohet e paligjshme në lidhje me nxitjen e urrejtjes. Kjo përbën bazë për të rekomanduar që ligjvënësit të marrin një hap prapa dhe të rishikojnë siç duhet këtë proces, duke dhënë kohë për konsultime dhe duke marrë parasysh numrin e nismave dhe të qasjeve të reja që po zhvillojnë praktikën më të mira në shtetet e tjera europiane në mbështetje të Këshillit të Europës dhe të Komisionit Europian.

Rekomandohet që komisioni i sapo krijuar i shtypit të mbështetet dhe të forcohet në mënyrë që të gjithë aktorët në fushën e medias së shkruar qoftë online, ose hotline të kenë standardet etike dhe një sistem vetërregullues të drejtimit të ankesave dhe të së drejtës për t'u përgjigjur, pra të ekzistojë siç duhet. Kjo mund të forcohet me vendosjen e një **aeckspot-i**, të një natyre bashkërregulluese përmes një gjykate të pavarur si edhe natyrisht me mundësimin e aksesit në mjetet gjyqësore.

Ndryshimet në ligjin për komunikimet elektronike varen nga ndryshimet në ligjin për medien. Vlen të përmenden se kërkesat për të hequr përmbajtjet me karakter kriminal, për shembull, të renditura në ligj, si: pornografia e fëmijëve, nxitja e akteve terroriste, shkeljet e sigurisë kombëtare, që kërkojnë heqjen e tyre kur një ndërmjetës në internet është i vetëdijshëm për përmbajtjen dhe ka mjete ose mënyrat për ta hequr atë. Kjo është një kërkesë e të gjitha

shteteve europiane përmes ligjeve të ndryshme të komunikimeve elektronike, madje është një kërkesë që vjen nga direktiva e tregtisë ose tregtisë elektronike.

Një aspekt thelbësor për të siguruar një medie të lirë dhe pluraliste është transparenca që lidhet me pronësinë. Dëshirojmë ta theksojmë këtë pikë këtu. Pra, rekomandohet që te regjistri për shërbimet mediatike të kërkohej edhe të dhëna për strukturën e pronësisë së medieve. Rekomandohet që autoritetet, duke u mbështetur te propozimi i OSBE-së në seancën e përbashkët ose duke pasqyruar rekomandimin e OSBE-së, të marrin masa për të garantuar transparencë të pronësisë së medieve në Shqipëri. Me përfshirjen e regjistrimit të medieve në këtë ligj ekziston po ashtu edhe mundësia për të krijuar disa detaje që lidhen me pronësinë medieve.

Rekomandohet që të kërkohej një vendim i mëtijshëm juridik mbi versionin e fundit të propozimeve për ndryshim. Ofrimi i opinioneve ligjore dhe hartimi i ligjeve për medien audiovizuale konsiderohet një element thelbësor i punës së Këshillit të Europës për promovimin e lirisë së shprehjes. Madje në vitin 2017 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës në rezolutën e saj numër 2179, paragrafi 7, rekomandoi si më poshtë: “Shtetet anëtare të Këshillit të Europës të kërkojnë rishikime të pavarura të ligjeve dhe praktikave të tyre, të cilat kanë ose mund të kenë një efekt qetësues në lirinë e medieve, siç janë ato për sigurinë kombëtare, terrorizmin dhe shpifjen dhe t’u besojnë komisioneve për të drejtat e njeriut ose, për shembull institucioneve të ndryshme, si: Avokatit të Popullit, monitorimin e zbatimit të këtyre ligjeve dhe praktikave për të shmangur keqpërdorimin e tyre për të penguar lirinë e medieve.

Në mbyllje më lejoni të informoj Komisionin e Mediave në lidhje me një iniciativë, të cilën ne tashmë e kemi filluar në bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit. Në fakt, detyra e Avokatit të Popullit është në krye të kësaj taksforce, në lidhje me gjuhën e urrejtjes, pra për ta luftuar atë. Deri tani partnerët tanë janë si më poshtë vijon: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit dhe Komisioni i Shtypit që është një mekanizëm vetërregullator në fushën e gazetarisë. Shpresojmë shumë që po ashtu si AMA-n, të kemi në të ardhmen komisionerin për aksesin e informacionit.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

A do dikush tjetër nga përfaqësuesit të shtojë diçka?

Para se t’ua kaloj fjalën anëtarëve të komisionit, unë do të doja t’ju bëja me dije se kur nis një nisëm ligjore në Kuvend, ajo vendoset më parë në kalendarin e Kuvendit dhe miratohet në

mbledhjen e kryetarëve të komisioneve parlamentare. Me miratimin e projektligjit për t'u diskutuar në seancë plenare, fillon puna e çdo komisioni, e cila ndahet në tri momente të rëndësishme: miratimi në parim, i cili, para se të kryhet, duhet të shoqërohet me dëgjesa që vijnë nga ata që janë hartuesit e ligjit, ose edhe ata që janë personat kyç në bërjen dhe zbatimin e ligjit. Prandaj, ne kemi menduar që në komisionin tonë të kemi dëgjesa sot me tri grupe hartuesish të ligjit, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, që kanë shfaqur opinion për këtë projektligj dhe më pas do të vazhdohet me operatorët mediatikë. Me mbarimin e këtyre dëgjesave në komision, ne mund të kalojmë në diskutimin në parim të projektligjit. Në diskutimin nen për nen kemi parashikuar një listë të gjatë me të gjithë ata që janë persona të interesuar dhe kanë opinione për pjesë të ndryshme të neneve të këtij ligji, që vijnë si nga shoqatat e gazetarëve, si nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ata që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nga bota akademike, nga bota e sistemit gjyqësor, përfaqësues që vijnë nga dhomat e tregtisë dhe përfaqësues të tjerë, që i janë drejtuar komisionit gjatë periudhës që është diskutuar ky projektligj në medie ose kanë qenë në *siti*-n e parlamentit me opinionet e tyre. Të gjitha opinionet do të mblidhen në një matricë, e cila në këtë rast do të jetë e hartuar edhe në gjuhën shqipe, sepse kemi dashur që përkthimi juaj të regjistrohet edhe në gjuhën shqipe. Grupi i relatorëve të komisionit punon shumë ngushtë me grupin e shërbimit juridik të Kuvendit, për të kaluar në një draft paraprak, para se projektligji të vijë në komision sërish, për t'u diskutuar nen për nen. Me diskutimin nen për nen, kur ai merr formën finale, kalon në votim nen për nen dhe pastaj kalon në votim në tërësi. Pra, kjo është praktika e punës që ne ndjekim.

Unë nuk mund t'ju them si cili do të jetë rezultati i kësaj pune, sepse sapo ka filluar. Do të jetë rezultat i një procesi të gjatë dhe do të ndjekim hapat që janë të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit.

Për ne kjo dëgjese ishte shumë e rëndësishme, sepse ne jemi komision përgjegjës për njërin nga projektligjet, që ka të bëjë me amendimet në mediet audiovizive dhe jemi komision për dhënie mendimi në projektligjin tjetër, që ka të bëjë me tregtinë elektronike. Pa dyshim, do të punojmë në mënyrë paralele për të dyja, duke e ndarë procesin si për njërin ligj, ashtu edhe për tjetrin. Ndërkohë, mbase do të kërkojmë nga ju të kemi një lloj gatishmërie, që kur të kemi nevojë për të sqaruar diçka, të kemi nga një pikë kontakti pranë institucioneve tuaja, që të na mundësojë përgjigjen në një kohë sa më të shpejtë të pyetjeve që do të kemi nga këto amendime ose sugjerime që ju keni dhënë për këtë projektligj.

Unë do të sugjeroja që së bashku me mendimet në formë të shkruar të na sillnit edhe një *focuspoint* teknik të organizatës suaj, në mënyrë që ne të komunikojmë sa më lirshëm dhe më shpejt.

Tani fjala për ju.

Halit Valteri – Të nderuar kolegë,

Të nderuar të ftuar,

Jemi në një situatë ku qeveria sjell një projektligj të cilin e trumbeton me të madhe që do të garantojë lirinë e fjalës së lirë, por në të vërtetë do të kapë edhe ato pak medie që janë të lira.

OSBE-ja e ka kundërshtuar projektligjin e fundit të paketës antishpifje; gjithashtu, edhe organizata ndërkombëtare e medieve “Reporterë pa kufij”, e cila ka kërkuar që ky ligj të mos hyjë në fuqi siç është propozuar me variantin e përpunuar.

Në këtë situatë, ku disa organizata ndërkombëtare për mediet kanë dalë kundër, pasi cenojnë fjalën e lirë, edhe zoti Desir tha dje se është parësore të parashikohet një dispozitë që garanton se të gjitha vendimet e AMA-s mund të ankimohen në gjykatë menjëherë pas marrjes së tyre, ndërkohë që AMA dhe AKEP-i marrin kompetenca gjyqësore në këtë rast. Kam një pyetje për zotin Sala: Cili është qëndrimi, juaj si një nga institucionet që do të merrni më shumë fuqi nga ky projektligj? A do t'i merrni parasysh OSBE-ODIHR-in dhe shqetësimet e organizatave ndërkombëtare të medieve apo thjesht do të mbyllni sytë dhe do të kënaqni kapriçot e qeverisë dhe ERTV-së?

Para një jave AKEP-i ju dërgon një e-mail, sipas të cilit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka njoftuar zyrtarisht AKEP-in që nisur nga situata e krijuar në vendin tonë pas tërmetit të datës 26 dhjetor, me gjithë punën e bërë nga të gjitha autoritetet shtetërore dhe të medieve publike për sqarimin dhe sensibilizimin e qytetarëve, ka ende shtetas, portale dhe subjekte të ndryshme, të cilat duke shfrytëzuar rrjetet sociale dhe portalet e ndryshme, përhapin informacione të rreme, mashtrojnë, dezinformojnë dhe hapin llogari të ndryshme për të përhapur panik ose për të përfituar nga situata e krijuar. Është një e-mail, ku të gjitha kompanitë që shpërndajnë internet detyrohen të mbyllin subjektin “Jeta osh qejf”, që është një nga faqet me më shumë shikime dhe 1 milion klikime, dhe një nga faqet që kritikon vazhdimisht qeverinë, dhe një nga ato pak faqe që kanë mbetur pa u kapur nga qeveria. Mediet e kapura nga qeveria sot dalin si masha dhe vegla të qeverisë dhe detyrohen të mbyllin këtë. A doni të na çoni 100 vjet përpara? A doni të jeni ata të cilët të kontrolloni edhe faqet e Facebook-ut edhe faqet e internetit? Atëherë, më mirë të ngremë

të gjithë dorën, sepse ju rikujtojmë se qeveria i ka të gjithë numrat në këtë parlament që mund të votojë çfarë dhe si të dojë. Të lëmë vetëm ERTV-në hapur, t'i kërkojmë të gjithë medieve të mbyllen dhe njerëzit të punësohen të gjithë te televizioni i atij burrit që rri aty, dhe të dëgjojmë vetëm atë nga mëngjesi deri në darkë. Ka dalë një shprehje: “Hap frigoriferin, del Edi Rama”.

Ju lutem, në emër të opozitës parlamentare dhe grupit parlamentar demokrat, të mos lejohej të kalojë ky projektligj. T'i bëhet më shumë presion qeverisë dhe të ketë liri në medie. Këto televizione kombëtare i ka blerë të gjitha. Këtyre televizioneve kombëtare iu ndan çdo fillim viti nga 4-5 milionë euro nga paratë e taksapaguesve. Le t'i marrin edhe këto e të kërkojmë të gjithë azil, si parlament pastaj.

Milva Ekonomi- Këto fjalë kur thuhet, duhet të verifikohen, nuk mund të lëshohen kështu.

Patjetër, ky nuk është pikërisht momenti kur fjalët duhen lëshuar kështu, pa u verifikuar. Duhet të bëjmë kujdes.

Halit Valteri- Unë mbaj përgjegjësi për çdo gjë që them këtu.

Milva Ekonomi - Opinioni personal është gjë tjetër.

Kur përdor faktet, duhet të jesh i besueshëm.

Halit Valteri- Unë jam shumë i besueshëm për atë që them. Çdo fjalë që kam thënë për këta 6 muaj që jam në Kuvend, si në sallën e seancave, si në komisione, janë lehtësisht të verifikueshme. Kështu që jam deputet i ri dhe e kam përpara karrierën politike, dhe nuk vij këtu të bëj tellallin, nëse nuk kam informacione të sakta.

Kështu që ju sugjeroj të bashkoheni me mua dhe të mos i japim çdo gjë në dorë atij zotërisë.

Milva Ekonomi - Unë mendoj se një nga gjërat që duhet të kemi parasysh në komision është që opinioni personal për është diçka e jona, vjen nga dija dhe nga mendimi që kemi për një çështje, ndërsa kur përdorim fakte, duhet të jemi shumë të kujdesshëm për to, sepse ato kanë nevojë për verifikime.

Fjalën e ka zonja Kumbaro dhe, më pas, zoti Ulqini.

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Para se t'u drejtohem të ftuarve, do të doja të bëja një sqarim të shkurtër për kolegun, kur iu referua mundësisë për apelimin pranë një gjykate. Këtë gjë tashmë e keni të reflektuar në draftin e fundit, falë edhe bashkëpunimit, nuk dua ta nënvlerësoj, të ekspertëve dhe partnerëve tanë, në

nenin 27, pika 10, ku çdo vendim i Këshillit të Ankesave të AMA-s është i apelueshëm pranë gjykatave.

Kaq kisha për ju.

Tani dua t'u drejtohem të ftuarve: në radhë të parë, iu falënderoj të gjithëve për punën e gjatë!

Duke ju dëgjuar me vëmendje, por edhe duke ju referuar leximeve të të gjitha informacioneve që na kanë ardhur gradualisht në komision nga qeveria, është shumë evidente që, në fakt, draftet vijnë më vonë. Do të ishte shumë interesante që të kishim nga ju drejtpërsëdrejti informacion plotësues lidhur me draftet e prezantuara, deri te ky i fundit që ka ardhur me plotësimet më të fundit, çka dhe u konfirmua si nga fjala e përfaqësueses së OSBE-së, ashtu edhe nga fjala e zotit Dezir, dje në faqen e OSBE-së.

Unë besoj se ia vlen të theksojmë faktin që ky është një proces siç duhet të jetë. Mundet që draftet e para që vijnë në rastin konkret nga hartuesit e qeverisë së projektligjit, të kenë problematikat e tyre, siç është çdo draft i parë, i cilido lloj teksti, qoftë edhe atij letrar, ama fakti që ai draft ka hyrë në një proces diskutimi dhe konsultimi me institucione të ndryshme të shtetit, me grupe të ndryshme konsultimi dhe kur flasim për konsultim, nuk do të thotë që duhet të bien dakord të gjithë, sidomos me ekspertizën më të mirë të OSBE-së, të Bashkimit Europian, të Këshillit të Europës dhe të UNDP-së, do të thotë se ky proces është ai që duhet të jetë, i konsultuar, i dialoguar, i debatuar, i përmirësuar, çka ju e konfirmuat dhe më vjen shumë mirë që jemi në rrugën e duhur.

Ajo që kuptova nga përfaqësuesja e OSBE-së është që, pasi janë bërë shumë plotësime, kemi mbërritur në një version shumë më të mirë të vetëpranueshëm, që ka dy objektiva kryesorë: në radhë të parë, të shpëtojë lirinë e medias, e duam të gjithë këtë gjë, e kush më shumë se sa ne që dalim nga një diktaturë e gjatë, dhe, e dyta, të parandalojë dhe të ruajë atë që iu referua edhe përfaqësuesja e PNUD-it, rastet e kufizimit të lirisë së fjalës, përveç sigurisë kombëtare e të tjerë, mbrojtjes së shëndetit moral dhe shëndetit publik. Sigurisht, gjetja e objektivit midis këtyre dy objektivave nuk është gjë e lehtë, por për fat të mirë kemi disa rrugë të shtruara para nesh nga partnerët tanë dhe nga vende të tjera të Bashkimit Europian, të cilave ne iu jemi referuar, siç m'u përgjigjen përfaqësuesit e qeverisë, kur i pyeta a e kanë shpikur apo u janë referuar modeleve të tjera. Kështu mësova që u janë referuar modeleve të tjera, si atij gjerman, kroat, të Malit të Zi dhe të Serbisë, që u gjejnë një ekuilibër interesant për sa u përket modeleve krahasuese midis vendeve

të Bashkimit Europian, siç është Kroacia dhe Gjermania, duke vënë një theks të veçantë te ky i fundit, si një ndër vendet pararojë dhe referencialë, por edhe një partner i rëndësishëm, ashtu edhe vet Kroacia një vend ballkanik, Mali i Zi dhe Serbia, të cilët besoj, që po ashtu si ne, kur i kanë hartuar ato ligje, janë konsultuar dhe kanë qenë monitoruar nga të 4 organizatat që përfaqësohen këtu.

Nëse e kuptova drejt, unë shënova tri shqetësimet e OSBE-së që mbeten për t'u saktësuar dhe përmirësuar edhe në këtë draft të fundit: saktësim më të qartë të kompetencave të AMA-s, më korrigjoni nëse jam gabim; një shqetësim lidhur me gjobat, shqetësim që u nda këtu edhe nga përfaqësuesja e BE-së dhe nga PNUD-i, që të kemi një ndarje më të qartë në përkufizimin midis kritikave politike nga shpifja dhe lajmi i rremë.

Lidhur me gjobat, duke qenë se ky ishte një shqetësim i shumë prej jush, do të doja të dija, edhe falë eksperiencës suaj, krahasuar me këto vende të tjera me të cilat është punuar, si është niveli i gjobave për të njëjtat figura në Kroaci, Gjermani, Mal të Zi dhe Serbi. Janë proporcionalisht të larta dhe ne me to jemi aty-aty, që nuk do të më dukej problem i madh, nuk e kam fjalën për shifra konkrete, e kam në nivel krahasimor. Në informacionin tim, qofsha e gabuar, Gjermania ka një ligj të fortë lidhur me këto probleme dhe Franca e ka në vatrë më të nxehtë të diskutimit çështjen e lajmeve të rreme dhe shpifjeve. Krahasuar me këto vende, si është ky draft sipas mendimit tuaj? Pra, të mos kërkojmë diçka që nuk e kemi edhe në vendet e tjera, apo jemi në një masë të tillë që vetëm ne e paskemi dhe duhet ta konsiderojmë si komision për ta riparuar, sepse jemi në kohën e duhur dhe kjo është detyra jonë.

Kjo ishte e para.

Në reagimin e zonjës që përfaqëson PNUD-in, u tha se mbrojtja e dinjitetit, që është një ndër qëllimet, duhet të jetë çështje e gjykatave dhe jo e institucioneve të tjera. Parandalimi i cenimit të dinjitetit, a nuk duhet të jetë një ndër synimet e institucioneve, organizatave apo qoftë mekanizmave vetërregullues të medieve dhe medieve elektronike në përgjithësi?

Lidhur me shpjegimin që bëri zoti Sala, kur referoi vendimin e fundit të bordit, ku në një numër 3 me 2, pra 5 anëtarë të bordit, 3 kanë votuar kundër, ju thatë se arsyeimi i tyre ishte se kjo cenon lirinë e shprehjes. Më ndjeni, por më duket shumë e përgjithshme. A mund të na thoni se cilat ishin argumentet konkrete të tri anëtarëve që votuan kundër? Ku çalon konkretisht? Në qoftë se nuk i keni këtu, na i dërgoni me shkrim, ju lutem, që ne të mund t'i studiojmë, për të kuptuar më mirë se si ne, me rekomandimet tona, **mund ta përmirësojmë, edhe pse do t'i përfshijmë.**

Të thuash “në përgjithësi”, nuk e di fare kush janë 3 anëtarët dhe nuk më shqetëson kjo, se votoi kundër, kjo “në përgjithësi” cenon, më duket e pamjaftueshme, ndërkohë që do të ishte mirë të ishim më konstruktivë.

Besoj se këto ishin pak a shumë çfarë doja të thosha në një moment të parë. Ndoshta më lejohet më pas të rimarr fjalën.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Fjala për zotin Ulqini.

Musa Ulqini – Do të përpiqem të bëj disa komente të shkurtra në mungesë të mundësisë që kemi për të bërë një debat profesional me ekspertë, të cilët kanë bërë edhe analiza për projektligjin. Në gjykimin tim kjo është pothuajse seanca më e rëndësishme, sepse besoj se të gjithë biem dakord që në këtë seancë janë ftuar aktorë shumë të rëndësishëm, fjala e të cilëve ka qenë historikisht e rëndësishme për ne.

Ky ligj që amendohet, në Shqipëri është bërë për herë të parë në tetor të vitit 1998; ka firmën, ka vulën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të Këshillit të Europës, të zyrës së OSBE-së dhe të ekspertëve amerikanë. Kjo traditë ka vazhduar historikisht në Shqipëri për të gjitha ndryshimet e legjislacionit të medieve. Mesa kam dëgjuar dhe lexuar nga raportet e ndërkombëtarëve, legjislacionin e medieve e kemi të mirë në Shqipëri dhe klasifikohemi te shtetet me legjislacion të mirë, por kemi problem te zbatimi.

Lidhur me atë që u tha këtu nga përfaqësuesja e Këshillit të Europës, e cila lexoi disa rekomandime themelore, për të cilat nuk kam asnjë kundërshti, dua të shpreh tri gjykime për këto tri çështje: përse për medien *online* ka rregullime, ndërkohë që për medien e shkruar nuk ka? Këtu ka diçka që nuk shkon. Arsyeja themelore që bëhet ky ndryshim është pikërisht fakti që sot në Shqipëri media *online* jo vetëm që po lë në hije medien e shkruar, por edhe radion dhe televizionet. Pra, gazeta në Shqipëri janë shumë pak, ndërkohë që raportin e kemi 1 me 100, pra 1 gazetë me 100 portale. E para.

E dyta, medien *online* e përdorin të gjithë qytetarët në shumicë dërrmuese, ndërsa gazetatat kanë një audiencë të pakët dhe ndaj po shkojnë drejt falimentimit. Pra, ndikimi i kësaj medieje të re në formësimin demokratik të shoqërisë sonë është i jashtëzakonshëm dhe kjo është arsyeja pse kemi një projekt. Mua nuk më duket i gjetur si krahasim pse për medien e shkruar nuk ka dhe medien *online* ka. Besoj se jemi në trendin e kohës dhe ka qenë pikërisht kjo nevojë që kemi ardhur

te ky propozim. Ky ligj është bërë, siç thashë, në tetor 1998, sepse atëherë filluan të dalin mediet elektronike. Më parë nuk kishte medie elektronike në Shqipëri, por kishte vetëm një transmetues shtetëror. Kjo është një dukuri e re.

Së treti, me të drejtë ju flisni për mekanizma vetërregullues. Është një parim bazë, që e dëgjojmë në të gjitha takimit, për të flitet prej 30 vjetësh dhe unë kam 24 vjet që kam marrë pjesë në tryeza diskutimesh pa fund në Shqipëri dhe jashtë saj. Ne, anëtarët e këtij komisioni, duhet të prevalojmë te mekanizmat vetërregullues dhe jo te rregullimet ligjore. Për shumëçka që lidhet me mediet bie plotësisht dakord, por ja ku jemi sërish pas 30 vjetëve. Ku janë mekanizmat vetërregullues dhe kush e ka fajin këtu? E kanë partitë politike, maxhoranca apo opozita? Jo, ky është një problem që lidhet me nivelin e shoqërisë sonë, me nivelin e demokracisë, ku media është përgjegjëse për këtë punë, se as opozita, as qeveria nuk ngre mekanizma vetërregullues. Ne kemi hequr dorë nga ndikimi mbi ligjin, për të krijuar bazën e mekanizmave vetërregullues. Ka një Kod Etike shumë të mirë, po si zbatohet ai, cili është institucioni vetërregullues që i detyron gazetarët ta respektojnë atë? Në Shqipëri nuk ka. Kanë dështuar edhe organizatat ndërkombëtare. Shqipëria është i vetmi vend që nuk ka një sindikatë, ku gazetarët të ngrihen dhe të mbrojnë të drejtat e tyre përballë pronarëve dhe shtetit. Vetëm në Shqipëri gazetarët bëjnë protesta që t'u shtohen të ardhurat pronarëve. Pra, ky mekanizmi vetërregullues nuk mund të përjashtojë rregullimin ligjor për këtë çështje, sepse kemi një realitet 800-900 portale me një ndikim shumë të madh, ku 70 % të shqiptarëve përdorin celularin, domethënë është një gjë emergjente. Mekanizmi vetërregullues është një parim i madh demokratik. Le të themi se ne jemi përgjegjës, por kjo nuk e zgjidh çështjen.

Në fund fare, jam në dilemë të madhe, di që Europa, BE-ja e të tjerë, siç u thanë këtu, po përpiqen të bëjnë rregullime ligjore edhe në këtë fushë për mediet *online*. Është një gjë e nevojshme, sepse kjo medie e re po ndikon edhe në zgjedhje. Ka një debat të jashtëzakonshëm në Shtetet e Bashkuara për këtë. Është një çështje e madhe që evoluon me shpejtësi të jashtëzakonshme. Nuk mund ta zëvendësosh rregullimin ligjor me edukimin, pavarësisht se ato nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Departamenti i Gazetarisë, universitetet, OJF-të, ne, si komision, kemi një rol shumë të madh. Nuk bie dakord, flas në cilësinë e relatorit dhe kam një përgjegjësi më të madhe, por edhe për shkak të përvojës që kam këtu, që ta pengojmë procesin e amendimit të ligjit. Unë bie dakord që amendimin ta bëjmë me standardet e duhura, por nuk bie dakord që ta zëvendësojmë amendimin me edukimin. Nuk kemi bërë asnjë gabim, por e ka diktuar vetë zhvillimi i kësaj medie. Është një diskutim që bëhet kudo me shqetësim, po flas në qendra

demokratike, jo për shtete si Kina, Rusia e të tjerë, por për Shtetet e Bashkuara, BE-në, për Zyrën e Medieve të Këshillit të Europës në Strasburg, për Zyrën e Medieve të OSBE-së në Vjenë, po flas për të gjitha organizatat e pavarura, që mbulojnë mediet në të gjithë Europën dhe Shtetet e Bashkuara.

Pra, nuk isha kundër, as pro, por shtrova disa çështje që më mendojnë dhe, kur t'i lexojmë edhe raportet që do të vijnë, besoj se do të jemi më të qartë për të bërë më të mirën dhe jo për t'u bërë palë që konfliktojmë njëra-tjetrën. Besoj se në këtë pikë, jemi të gjithë për të bërë më të mirën dhe e mira bëhet duke diskutuar dhe jo duke i shmangur proceset.

Kostaq Papa – Përshëndetje!

Në pozitën që jemi sot, Shqipëria ndodhet para faktit që pushteti qendror dhe ai lokal është në duart e një krahu politik. Pushteti tjetër, gjyqësori, çalon ose është në momentin që po ndërtohet, të themi edhe anën e mirë të tij, përmes reformave që po bëhen, por Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë nuk funksionojnë mirë. Kjo paketë ligjore, përmes zhurmës që është bërë, krijon përshtypjen për një presion mbi medien, si pushtetin tjetër, i cili shpreh liritë, si një presion i qeverisë, i maxhorancës mbi medien e pavarur.

Për institucionet, OSBE-në, Këshillin e Europës, PNUD-in për BE-në dhe institucionet shqiptare këtu, pyetja ime është: nga përvoja juaj, do të ishit për shtyrje të ligjit, për ndryshim të ligjit, apo për ndonjë masë tjetër më të vështirë, diktuar nga situata në të cilën jemi në konditat politike, apo sugjeroni për krijimin e ndonjë institucioni ose zyre për të frenuar presionin mbi medien e lirë përmes kësaj pakete anti-shpifje?

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Është pyetja e fundit dhe, më pas, do t'u jepet fjala përfaqësuesve.

Urdhëroni, Ismet.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Është një kënaqësi që përveç institucioneve qendrore të vendit në këtë tryezë kemi edhe përfaqësues të OSBE-së, Këshillit të Europës, PNUD-it, BE-së, të cilët asistojnë, ndihmojnë dhe rekomandojnë për të gjitha reformat që ka ndërmarrë Shqipëria këta 30 vjet dhe tani jemi në kulmin e reformave, ku shumë shpejt do të cekim edhe rezultatet e tyre.

Reforma mediatike në fushën e medias është një nga reformat më të rëndësishme, e klasifikuar si pushteti i katërt. Unë do të bëja disa pyetje që kanë të bëjnë edhe me çka ju

rekomanduat sot. Aktualisht sot kemi filluar diskutimin në parim edhe me palët e interesuara për draftin, i cili ka marrë në konsideratë vërejtjet që kanë bërë përfaqësuesit e OSBE-së, kryesisht Këshillit të Europës e të tjerë. Do të doja të dija nëse jeni vënë në dijeni për variantin e fundit që kemi sipër tryezës, sepse këtu u shtrua diskutimi lidhur me vendimmarrjen finale, duke iu drejtuar edhe ankimimit sipas procedurave administrative, ligjore që janë në fuqi në gjykata, gjë që këtu përfshihej. Ndërkohë e dëgjuam edhe nga rekomandimet që u bënë.

Pyetja e dytë: mediet elektronike kanë marrë zhvillim dhe trend dhe kanë lënë pothuajse në stanjacion mediet tradicionale. Ky shërbim që jepet, a ka informalitet, se në finale medie quhet, dhe a duhet rregulluar ky informalitet nëpërmjet Kodit Rregullator, që në finale është kuadri ligjor, pikërisht në këto dy ligje që ne po bëjmë disa ndryshime dhe shtesa, apo do t'i lëmë sikurse janë në terrenin mediatik shqiptar?

Së treti, disa nga rekomandimet tuaja, ndjesë, mos bien ndesh me frymën që ka në institucionet qendrore të Bashkimit European? A është diskutuar gjatë këtij viti lidhur me dëmet dhe pasojat që shkakton disinformimi dhe sidomos te lajmet?

Milva Ekonomi - Kush e do fjalën nga përfaqësuesit?

Gentian Sala – Meqë ishte pyetja e parë e deputetit që u largua, për AMA-n. Cili është qëndrimi i AMA-s për ligjin e bëra public. AMA ka një praktikë 3-vjeçare që çdo draftligj e diskuton në bordin e saj. Bordi ka vendosur që të shprehë të kundërtën.

Pyetja e deputetit ishte: do të dëgjoni partnerët ndërkombëtarë apo do të dëgjoni qeverinë? Ne do të dëgjojmë ligjin. Ne jemi kundër, por, po e vendosi parlamenti, do ta zbatojmë, nuk ka diskutim.

Po u përgjigjem pyetjeve të zonjës Kumbaro: cilat ishin komentet e anëtarëve të bordit që vendosën të ishin kundër propozimit? Unë i lexoj paragrafët, nuk po i interpretoj. Anëtarët e bordit: zoti Sami Neza, zonja Suela Musta dhe zoti Agron Gjokmarkaj u shprehën kundër në parim për propozimin e ardhur, duke theksuar se këto ndryshime bien ndesh me kuadrin kushtetues dhe cenojnë lirinë e shprehjes, dhe se përmes këtij projektligji të propozuar nga qeveria synohet të eliminohet dhe të cenohet veprimtaria e lirë e medieve *online*. Sipas këtyre anëtarëve: “Propozimet e shndërrojnë AMA-n nga një organ rregullator dhe mbikëqyrës të medieve audiovizive, në një organ prokurorie, si dhe e zgjerojnë fushën e veprimit të këtij organi në kategori subjektesh, që duhet ta ushtrojnë veprimtarinë lirshëm në treg. Propozimet e qeverisë e ndrydhnin lirinë dhe zhvillimin e medias informative *online*. Propozimet e qeverisë anashkalojnë një nga parimet më

të rëndësishme të medias së shkruar, atë të vetërregullimit, ndërkohë që aktet ndërkombëtare dhe veçmas direktivat e BE-së për medien audiovizive, inkurajojnë dhe vetërregullatorët i japin përparësi këtij parimi”.

Paragrafi i fundit, sipas tyre: “Ndryshimet në ligj nuk janë mbështetur në praktikat e vendeve të lira dhe demokratike, duke i dhënë AMA-s, një institucion i pavarur parlamentar, ndër të tjera, edhe kompetenca për vlerësimin e përmbajtjeve editoriale të medieve”.

Milva Ekonomi – A dëshiron kush të flasë?

Monika Bylaite (në anglisht).

Artes Butka (përkthen) - Në fakt, do të përpiqem shkurtimisht t’u përgjigjem pyetjeve që u bënë për ne.

Së pari, për ato elemente që u përmendën si fillim se si janë parë të gjitha rishikimet e mëparshme dhe që janë bërë këto përmirësime që prej dhjetorit, për këtë arsye, për rrjedhojë, u tha se ky version që është tashmë në tryezë, është i pranueshëm. Besoj se këtu duhet bërë një dallim ndërmjet punës që ne po bëjmë në vijimësi, me komentet që dërgojmë, punës që bëhet me hartuesit me këtë tjetrën, pra nëse quhet i pranueshëm si version apo jo.

Ndërsa në lidhje me shqetësimet, besoj se ne i bëmë shumë të qarta të gjitha shqetësimet dhe ato u ngritën nga të katra institucionet, të cilat janë këtu të pranishme. Pra, në përgjigje të pyetjes suaj, po, ne, në fakt, e kemi parë edhe versionin e fundit dhe është pikërisht ai version me të cilin po punoni ju që e keni në tryezë dhe do të diskutohet. Natyrisht, ne kemi shprehur shqetësimet tona edhe për versionet e mëparshme. Po ashtu, kemi parë që ka pasur përmirësime të qarta dhe konkrete, të cilat, tashmë, janë marrë parasysh gjatë muajve të fundit dhe janë bërë pjesë e versionit të fundit. Pra, edhe këtë gjë e shikojnë. Megjithatë, Bashkimi Europian është shprehur shumë qartë në lidhje me qëndrimin e tij edhe më parë, pra që janë parë pikërisht këto çështje dhe puna që është bërë deri tani. Kishte disa çështje shqetësuese, të cilat janë marrë parasysh, por, në lidhje me legjislacionin e Bashkimit Europian, ka ende disa shqetësime që kanë të bëjnë në mënyrë të veçantë me çështje si liria e shprehjes. Të gjitha këto çështje janë shprehur fare qartë nga të gjithë kolegët tanë, nga OSBE-ja, nga Këshilli i Europës dhe nga zyra e koordinatorit të përhershëm të OKB-së.

Në lidhje me pyetjen që kishte të bënte me frymën e këtyre ndryshimeve, pra nëse këto ndryshime ose rekomandime që u bënë mos vallë ishin në kundërshtim me frymën e përgjithshme të Bashkimit Europian për këtë çështje, më lejoni të përsëris edhe një herë atë që thashë që në

fillim: ne ju kuptojmë dhe kuptojmë që ju dëshironi ta trajtoni çështjen e dezinformimit sa më mirë që të jetë e mundur. Megjithatë, duke marrë parasysh komunikimin e Bashkimit Europian për trajtimin e çështjes së lajmeve të rrema dhe dezinformimit, ne edhe një herë jemi të mendimit që duhen marrë parasysh disa masa më të buta, sidomos ato që kanë të bëjnë me vetërregullimin.

Në mbyllje, për pyetjen që u bë: nëse duhet filluar gjithçka nga e para, nëse duhet të ketë ndonjë shtyrje, më lejoni të them atë që është përmendur edhe më parë dhe që është tejet e rëndësishme. Ne sërish edhe një herë besojmë që duhet të ketë një procedurë konsultimi të plotë dhe shteruese, e cila duhet të organizohet dhe të vazhdojë deri në fund në lidhje me këtë çështje, duke u konsultuar me komunitetin e gazetarëve, me të gjitha palët e interesuara, me komunitetin ndërkombëtar, duke marrë të gjithë ekspertizën e mundshme. Në fakt, herën e shkuar, me çfarë mbaj mend unë, ishte përfaqësuesja e Këshillit të Europës, e cila tha se ndoshta gjëja më e mirë do të ishte që të bënim një hap mbrapa, duke e riparë këtë gjë që prej fillimit fare. Por edhe një herë më lejoni të them se ky vendim nuk është në dorën tonë, nuk jemi ne ata që e marrim këtë vendim për ju. Jeni ju ata që do ta vendosni këtë gjë, por gjithnjë duke pasur parasysh që ju do të merrni në konsideratë të gjitha komentet që ju bëhen në lidhje me këtë çështje.

Faleminderit!

(Irina Radu flet anglisht.)

Mirela Kumbaro – Vetëm një sqarim, krahasimin e kisha proporcional, jo absolut që të jemi të qartë.

Irina Radu *(anglisht).*

Milva Ekonomi *(anglisht).*

Mbyllet pika e tretë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me përfaqësues të medieave audiovizive për diskutimin projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", *komisioni përgjegjes*.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama dhe Erion Piciri.

Mungon:

Fatjona Dhimitri, Enada Kapllani, Amra Barova, Selami Jenishehri.

Të ftuar:

Brahim Shima – drejtor i Informacionit në radiotëlvizionin "Ora News",
Sokol Gjoshi – drejtori Juridik në RTSH.

Vijon pika e katërt e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Mirëdita!

Faleminderit kolegë që nuk u tërhoqët nga vazhdimi i punës së komisionit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

U lajmëruan.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Muhamet, shiko pak kush është jashtë dhe thuaj të futet brenda.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne ftesat i kemi dërguar, prandaj do të vazhdojmë punën me dëgjuesat.

Ju, kolegë, përfaqësues të medieve, që jeni këtu, faleminderit që keni ardhur!

Ne do të bëjmë një shpjegim për këtë ligj, që është shumë i rëndësishëm, ashtu siç bën ky komision sa herë që ka dëgjues.

Në këtë komision dëgjuesat janë të gjata, prandaj kërkojmë që fjalën tuaj ta sillni edhe me shkrim, sepse të gjitha mesazhet që vijnë me shkrim, futen në një tabelë *matrix* dhe çdo gjë ne e marrim në konsideratë, si në vështirimin e përgjithshëm të ligjit, por edhe në përmirësimet nen për nen, që bëhen sipas propozimeve që vijnë nga palët e ftuara në komision.

Natyrisht, ju jeni sensibilizuar më shumë se të gjithë të tjerët për këtë ligj, por ndërkohë dua t'ju bëj me dije që në këtë komision kemi pasur disa grupe në dëgjues. Dëgjuesi e parë ka nisur me hartuesit e këtij ligji, pastaj kemi ftuar AKEP-in, AMA-n dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare që kanë dhënë kontribut në hartimin e këtij ligji dhe kanë shprehur opinionin e tyre për situatën e ligjit sot.

Ju keni në dorë variantin final të punuar deri më tani për këtë projektligj, sepse kanë qarkulluar disa variante. Ky variant ka dakordësi për një pjesë të komenteve që kanë ardhur nga OSBE-ja.

Kjo iniciativë ka të bëjë më shumë me sigurinë e informacionit dhe ruajtjen e privatësisë së individit, ndërkohë kërkohet një shtyrje për vetërregullimin. Pra, meqenëse vetërregullimi është një proces që kërkon më shumë angazhime si nga medie, ashtu dhe nga qytetarët, kërkohet të ketë një kufi që të vendoset mbi disa baza ligjore, ndërsa pjesa tjetër të vinte si kontribut i medieve dhe i qytetarëve. Pavarësisht nga kjo, ne e kemi variantin e fundit të projektligjit. Deri tani kemi mbledhur opinione me shkrim, kemi bërë dëgjues me ju që jeni më të rëndësishmit e këtij procesi dhe pastaj do të kalojmë në diskutimet në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Përpara se të vazhdojmë, ju kërkoj që, kur të merrni fjalën, të prezantoheni, jo se nuk ju njohim, por për efekt regjistrimi. Gjithashtu, mos harroni që materialin të na e dërgoni me shkrim.

Faleminderit!

Sokol Gjoshi – Së pari, ju falënderoj për ftesën! Unë jam njohur me projektligjin dhe ky projektligj nuk prek fare kapitullin që rregullon veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar, por kryesisht është për mediat *online*, pra për portalet. Prandaj, ne nuk kemi ndonjë koment për të dhënë, pasi nuk prek veprimtarinë e RTSH-së. Por nga pikëpamja e përgjithshme si jurist në këtë rast, nga ana e teknikës legislative është pak e zgjatur, më shumë si formë e rregullores dhe mendoj se në shumë raste mund të përmbliidhen, pra ato që thuhet për median audiovizive, mund të jenë edhe për medien elektronike, pra dallimi mes televizioneve tradicionale dhe portaleve që janë hapur kohët e fundit. Këto kisha për të thënë.

Brahim Shima – Unë jam drejtor i informacionit në radiotelevizionin “Ora” dhe “Ora News”. Ndryshe nga Televizioni Shqiptar, “Ora News” preket shumë nga këto pika, sepse kemi edhe faqen *online*. Ne shprehim besimin, ashtu siç e thatë edhe ju, që nisma ka një efekt pozitiv, duke parë shtrirjen e gjerë të medias elektronike. Pra, është e nevojshme një formë rregullimi, që të mos kemi rrjedhje apo vjedhje të informacionit nga mediat tradicionale, që kanë stafin e duhur për të pasqyruar lajmin real, pra që kanë profesionistët e duhur. Megjithatë, ne kemi disa rezerva. Në fakt, unë nuk jam përgatitur për propozimet nen për nen, por kam disa opinione në disa pika.

Milva Ekonomi – Në çdo moment gjatë këtyre ditëve jeni të mirëpritur t’i dërgoni në sekretarinë tonë.

Brahim Shima – Në nenin 7, ndoshta, duhet bërë një rregullim jo i konsiderueshëm, por fjala “AMA” besoj se bie dhe shkurtimi duhet të ishte “AMSH”.

Nuk e di nëse kam projektin e duhur apo është projekt tjetër, por në nenin 1 të ligjit thuhet: “Promovimin e pluralizmit të medias...”, në fakt çdo ligj në parim që vendoset për mediat nuk fuqizon pluralizmin, por konsiderohet një ndëshkim ose presion që bëhet për të kufizuar një zhvillim të ri. Pra, kjo nuk ka kuptim, sepse parimi është i tillë.

Në nenin 6, ku përcaktohen ndryshimet e nenit 4/1, përcaktohet: “Dispozitat e këtij ligji nuk mund të interpretohen në mënyrë të tillë, që të japin të drejtën për të censuruar apo kufizuar të drejtën për lirinë e fjalës ose lirinë e shprehjes. Ky ligj mund të interpretohet sipas konventave ndërkombëtare”. Në fakt, edhe kjo nuk ka kuptim, sepse vetë propozuesit shprehin frikën se kjo mund të konsiderohet censurim. Pra, vetë përcaktimi i këtij neni, për mendimin tonë, është i tepërt, sepse shpreh frikën që ky është censurim, përndryshe nuk kishte përse të përfshihej.

Gjithashtu, përcaktohet edhe cenimi i reputacionit. Ky është një term relativ. Cili është cenimi i relacionit? Nëse media nuk do të merret me lajme me persona që bëjnë shkelje e të tjera,

atëherë cili do të quhet cenim i reputacionit? Pra, futemi në një konflikt që është aq parimor, sa dhe ligjor. Pra, edhe kjo është një pikë që duhet të rregullohet dhe një përcaktim i tillë do të sillte censurim apo autocesturim të gazetarëve. Pra, frika që unë po merrem me një ngjarje që përcakton një person konkret, mund të konsiderohet cenim reputacioni.

Citoj: “Ndryshimet dhe kufizimet e medias mund të ecin paralelisht me lehtësira për të drejtën e informimit dhe qasjes së medias në marrjen e informacioneve”. Pra, a kanë gazetarët hapësirën e duhur për të marrë informacionin në kohë reale dhe të duhur? Ndodh shpesh që institucionet apo personat e prekur në afëra të ndryshme, që janë në shkelje të ligjit, e vonojnë marrjen e informacionit. Kjo a do të sjellë një prekje të medias, pra që të mos japin lajmin e duhur në kohën e duhur?

Një tjetër pikë, “AMA merr të drejtën deri në mbyllje dhe pezullim të licencës së një rrjeti elektronik”, pra faqeve *online*. A i shërben kjo lirisë së mendimit? Pra, në çdo kufi AMA merr vendimin dhe thotë që kjo faqe e ka tejkaluar masën dhe e mbyll. Por a do t’i shërbejë kjo rregullimit të medias? A i shërben kjo verifikimit dhe dhënies së lajmit real ashtu siç është? Sa garanci kemi për një vendim të drejtë dhe të paanshëm nga AMA? Çdokush ka të drejtën e reagimit, mediet e kanë pasur dhe e kanë gjithmonë që një personi të prekur, kur ka fakte të ndryshme, gjithmonë i jepet hapësira e reagimit, por vendosja e prekses së reputacionit shkon përtej lajmit.

Radiotelevizioni “Ora” ka besimin se AMA deri më sot e ka kryer misionin e duhur, ka dhënë vendimet e saj në rregullimin e medias audiovizive, por kalimi i të gjithë pushtetit të medias së shkruar audiovizive dhe elektronike tek AMA a do të sjellë garanci që të kemi një medie transparente dhe të lirë? Kush e jep këtë garanci? Ne e dimë që politika shpesh ka ndërhyrë në institucionet vendimmarrëse. Kush na jep garanci që në një të ardhme AMA do të jetë tërësisht politike dhe do të sulmojë mediat kritike? Ne kemi përshtypjen se këto kompetenca shtohen shumë për AMA-n dhe mendojmë se duhet krijuar një organizim tjetër për kontrollin dhe ta shtyjë drejt vetërregullimit median shqiptare, sidomos atë elektronike.

Në fund, gjobat e parashikuara nuk shkojnë në proporcion të drejtë me situatën që janë mediet në Shqipëri. Duhet thënë që mediet, sidomos ato elektronike, nuk e kanë fuqinë financiare që duhet dhe duke shtuar gjobat, të cilat janë trefishuar me ato aktuale, e në disa raste edhe më lart, do të shkojnë drejt mbylljes. A i shërben kjo dhënies së informacionit dhe paraqitjes së realitetit

në Shqipëri? Këto janë çështje që ne na shtyjnë të paraqesim këto pika, të cilat, për mendimin tonë, duhen riparë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Shqetësimet që lidhen me rolin e AMA-s dhe masën e gjobave u ngritën edhe nga ndërkombëtarët që erdhën në dëgjuesë. Edhe ata kanë depozituar shënimet e tyre. Ne bëmë disa pyetje për të qartësuar opinionin e ekspertëve për këto gjëra. Kolegët kanë ndonjë pyetje?

Pak a shumë është e njëjta linjë në qëndrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sokol Gjoshi - Në diskutimin nen për nen janë shumë gjëra teknike për t'u rregulluar. Për shembull, emërtimi i titullit në disa vende është ndryshe, pra Autoriteti Shqiptar i Mediave dhe Autoriteti Mediave në Shqipëri. Por këto besoj se janë gjëra teknike.

Milva Ekonomi – *(Flet pa mikrofon)*... që lidhen me rolin e AMA-s, me masën e gjobave dhe me vetërregullimin e medies. Këto ishin 3 nga 4 çështjet që u ngritën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sokol Gjoshi - Në ligjin aktual që është në fuqi nr. 97/2013, është shprehur shprehimisht te objekti, që ky ligj nuk është për median e shkruar, ndërkohë në këtë draft, kjo nuk është e përcaktuar. Është e vërtetë ajo që në një pjesë flitet edhe për median e shkruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tek objekti duhet të shtohet, sepse ligji aktual e ka të përcaktuar shprehimisht që nuk është për median e shkruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Ulqini, është tek objekti.

Milva Ekonomi – Do ta mbajmë shënim dhe do ta shikojmë me patjetër.

Ne i falënderojmë shumë të ftuarit për gatishmërinë dhe për këmbënguljen që kishin për të sqaruar gjëra, të cilat edhe ne i kemi të qarta, por është shumë mirë kur i dëgjojmë nga ju, sepse kjo i shërben punës së komisionit që do të bëjë në vijim. Zotërinjve u kërkojmë të drejtën që nëpërmjet *email*-it dhe telefonit t'ju kontaktojmë, nëse do të kemi nevojë për sqarime të mëtejshme.

Ne ju falënderojmë shumë. Punë të mbarë!

Ne vazhdojmë diskutimin me pjesën e dytë të mbledhjes, i cila ndahet në dy momente. Momenti i parë ka të bëjë me diskutimin për kalimin në parim të projektligjit dhe momenti i dytë me vazhdimin e dëgjësave për projektligjin, që ne të fillojmë diskutimet nen për nen dhe në tërësi.

Kush e do fjalën për të diskutuar në parim? Relatorë është Musai dhe unë, kishim edhe një dyshe tjetër relatorësh që ishte Erioni me Fatjonën nga ana juaj, por Erioni u tërhoq në mbledhjen e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, të bëjmë diskutimet dhe ta kalojmë në parim, pastaj të biem dakord për dëgjesat që do të kemi në ditët në vazhdim, të cilat janë shumë të rëndësishme.

Puna për projektligjin do të jetë e gjatë në komisionin tonë, pra do të na kërkojnë të bëjmë ditë maratonë, siç thuhet te Komisioni i Ligjeve, për të punuar. Ne kemi edhe një kalendar veprimtarie që na kërkon të japim opinion për këtë. Kalon apo nuk kalon ligji në këtë seancë, kjo është një çështje tjetër, që vendoset nga Konferenca e Kryetarëve. Pra, ne duhet të kryejmë veprimtarinë për këtë situatë të kalendarit që kemi përpara.

Zoti Ulqini, doni të shtoni diçka?

Musa Ulqini – Hezitoj të jap një mendim preciz, sepse mendoj se te ky projektligj, për shkak të sensibilitetit që ka, duhen marrë në konsideratë disa gjëra. Kalimi në parim sot mund të krijojë një problem te mediet e përfomuar, mediet armiqësore dhe te ndërkombëtarët, që i shikojnë gjërat në mënyrë të çuditshme. Nganjëherë krijohen edhe keqkuptime, siç ishte deklarata e djeshme e përfaqësuesit të OSBE-së, i cili thoshte që është hequr nga ligji e drejta e individëve për t'u ankuar për një vendim të AMA-s, ndërkohë që kjo çështje është në projektligj. Pra, hezitoj të jap një mendim për shkak të sensibilitetit. Ne duhet t'i marrim të gjitha propozimet, të cilat janë të shumta...

Milva Ekonomi – Të mbarojmë të gjitha dëgjesat dhe përpara se të kalojmë në diskutimin nen për nen, të kalojmë në diskutimin në parim, pastaj nen për nen dhe në tërësi

Musa Ulqini – Krijohet përshtypja sikur ne po bëjmë një formalitet demokratik, i cili nuk ka peshë, sepse e kanë miratuar në parim. Dhe ne duhet ta shmangim këtë gjë, sepse krijohet një keqkuptim i panevojshëm, për shkak të sensibilitetit që ka çështja. Ne procedurën e kemi në rregull.

Milva Ekonomi – A jeni dakord të veprojmë kështu?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Këtë do ta bëjmë në ditët në vazhdim, pasi të mbarojmë dëgjesat.

Nesër fillojmë dëgjesa në orën 10:00.

Po, Ariana.

(Sekretarja flet pa mikrofon.)

A ju kujtohet që na erdhi një letër që e kemi diskutuar në një mbledhje komisioni, ku kemi rënë dakord për t'i kthyer përgjigje dhe ua kemi shkruar? Të gjitha këto organizata që na kanë shkruar, i kemi ftuar për dëgjese në mënyrë specifike.

(Sekretarja flet pa mikrofon.)

Të fundit.

(Sekretarja flet pa mikrofon.)

Ata letrën e kanë sjellë me shkrim. Ata do të mbajnë qëndrimin e tyre dhe ne do t'u bëjmë pyetje. Ata do të kenë në dispozicion 20 minuta për të shprehur qëndrimin e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Sekretarja flet pa mikrofon.)

Këtë pjesë ne e ndajmë, sepse kemi thënë se ata që janë të regjistruar, do të jenë të parët.

(Sekretarja flet pa mikrofon.)

Këta janë për në orën 11:00.

Sa jua kemi lënë këtyre hapësirën, se këta duan pak kohë?

Sekretarja – Jua kemi lënë deri në fund, sepse në fund kemi hequr shoqatat e biznesit. Kështu që për nesër janë vetëm këta.

Milva Ekonomi – Në rregull!

Neve na mbeten vetëm shoqatat e të drejtave të njeriut, të cilat nuk janë regjistruar dhe do të thirren sipas një liste që e ka Kuvendi, por për këtë duhet të marrim një vendim. Gjithashtu, kemi edhe një listë gazetarësh. Gazetarët janë rreth 40 vetë, apo jo?

Sekretarja – Unë kam nxjerrë këtë listë.

Milva Ekonomi – Gazetarët janë për pasnesër, ndaj unë dhe Ariana mendojmë se lista e gazetarëve duhet të grupohet në 4 grupe, pasi 40 veta nuk kemi ku t'i ulim këtu, por mund të ulim vetëm 10 prej tyre.

Sekretarja – Sepse edhe komunikimi bëhet i pamundur.

Milva Ekonomi – Pra, a t'i ndajmë në 4 grupe apo t'i thërrasim sipas gazetave?

(Diskutime pa mikrofon.)

Sipas alfabetit, se nuk kemi mënyrë tjetër që t’i ndajmë, sepse nuk e dimë se kush është më i rëndësishëm.

Sekretarja – I thërrasim sipas grupeve, siç i kam unë këtu të shkruara. Të parët kemi përfaqësuesit nga bota akademike, gazetaria dhe juridiku dhe do të thërrasim juridikun dhe departamentin e gazetarisë.

Milva Ekonomi – Kush është kryetari i departamentit?

(Diskutime pa mikrofon.)

Sekretarja - Shefi i departamentit të gazetarisë është Mark Marku.

(Diskutime pa mikrofon.)

Më pas, vjen sistemi gjyqësor. Çfarë doni nga sistemi gjyqësor?

Milva Ekonomi – Në qoftë se janë të njëjtët që do të dëgjohen te Komisioni i Ligjeve, nuk kemi pse t’i thërrasim këtu.

Sekretarja – Atëherë, mbetet grupi i madh i përfaqësuesve të medieve të ndryshme dhe kemi këtu emrat.

Milva Ekonomi – Atëherë emrat janë: Adriatik Doci, Aleksandër Furxhi, Alqi Kociko, Andi Tela, Andi Bushati.

Andi Telën ne e thirrëm sot, por nuk erdhi, ndaj hiqe nga lista.

(Diskutime pa mikrofon.)

Pra, Andi Bushati, Anila Basha, Arjan Vasjari, Arjon Sulo, Armand Mero, Artan Hoxha, Ben Andoni, Ben Koleka, Bledar Zaganjori, Brahim Shima, Eduard Zaloshnja, Elton...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Brahim Shima është gazetar i “Ora News”-it.

Eduard Zaloshnja, Elton Metaj, Enton Abilekaj, Ilva Tare, Karlo Bolino...

A ta thërrasim Karlo Bolinën?

(Diskutime pa mikrofon.)

Lorenc Vangjeli, Lutfi Dervishi, Mentor Kikia, Mentor Nazarko, Mero Baze, Roland Zili, Skënder Minxhozi, Sokol Balla, Bledi Hoti, Mimoza Haxhia, Anila Jole, Ejsi Konomi dhe Marsela Karapanxho.

A bëjmë një grup të vogël vetëm për 5 mediet e shkruara?

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, dua t’ju kërkoj një gjë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fidel Ylli - Unë mendoj që të mos merremi me emra gazetarësh, por të marrim shoqatat e gazetarëve, sepse të gjitha mediet kanë portale. Pra, jemi të detyruar që t'i marrim, për shembull, "Top Channel"-i ka portalin e tij, televizioni "A2" ka portalin e tij, televizioni "Klani" ka portalin e tij dhe detyrimisht këtu le të vijnë drejtorët apo kushdo që do ta përfaqësojë institucionin e tij.

Milva Ekonomi – Ata që i kishim thirrur, nuk erdhën.

Fidel Ylli - Le të mos vijnë, nuk ka rëndësi! Nëse ata nuk vijnë, ka të tjerë.

Milva Ekonomi – Le të heqim gazetarët dhe të vendosim shoqatat.

Sekretarja - Një pjesë e shoqatave janë nesër.

Milva Ekonomi – Ne do të vendosim ata që nuk janë.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, ata që nuk i kemi ftuar, jo ata që nuk kanë sjellë përfaqësues, por ata që nuk i kemi ftuar në fund të ditës së nesërme, i thërrasim pasnesër si shoqata. Dakord? Pra, do të thërrasim vetëm shoqatat dhe ata, të cilët nuk i kemi ftuar...

(Diskutime pa mikrofon.)

Gazetarët nominalë që, në fakt, janë shprehur për këtë gjë, por u fut e gjithë lista e gazetarëve, sepse këtu duhet të thirren vetëm gazetarët nominalë që kanë mbajtur qëndrim, por, ndërkohë, u futën të gjithë. Atëherë, vetëm shoqatat...

Mirela Kumbaro – A ka departament tjetër të komunikimit dhe të medieve në të tjera universitete?

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse ne do të marrim nga bota universitare, nuk kemi pse e limitojmë vetëm në një departament, ndërkohë që mund të ketë një interes tjetër, pra do t'i marrim me kategori përfaqësues të botës universitare të sektorit, siç morëm shoqatat. Pra, kam një pyetje për këtë gjë.

Më ndjeni nëse po bëj një sugjerim, por kjo ka të bëjë direkt me Ministrinë e Arsimit, sepse mund ta konsumojmë dhe për gjysmë ore. Nejse, unë ju jap edhe një përgjigje në rrugë informale.

(Diskutime pa mikrofon.)

Kështu është më e thjeshtë, sepse dekanati mund të bëjë për të gjitha universitetet. Ne mund ta bëjmë për ato fakultete në të cilat ka degë komunikimi, për shembull, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka degë të komunikimit, të cilët janë të predispozuar të bëhen gazetarë dhe shumë prej gazetarëve, edhe nga emrat që lexuat ju, treçereku i tyre vijnë nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të

formuar ndër vite, që më pas janë bërë gazetarë profesionistë. Kështu që, ne mund ta drejtojmë kërkesën te fakultetet, të cilat kanë në profilin e tyre komunikimin dhe automatikisht i bie medias, qoftë pedagogë, qoftë studentë, të cilët ushqejnë tregun e medieve elektronike, të portaleve dhe të publikimeve *online*. Kështu që unë mendoj se nuk kemi arsye pse duhet ta kufizojmë, ose do t'u dërgojmë njoftim të gjithëve dhe do t'u themi: “ Ne do të bëjmë dëgjese, ju lutem, na dërgoni një përfaqësues të fushës” dhe ta vendosin dekanatet përkatëse se kë duan ata të dërgojnë, që i bie të jenë Fakulteti i Histori-Filologjisë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Elbasanit, sepse nuk e di cili është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo departamentet, por fakultetet në nivel dekanati. Pra, unë propozoj që kërkesën ta bëjmë në formë zyrtare për nivelin e dekanateve.

Milva Ekonomi – Këtë ta bëjmë pasnesër?

Ismet Beqiraj - Unë e mbështes propozimin e koleges.

Mirela Kumbaro – Kështu, i dëgjojmë të gjithë ata në një seancë. Ne jemi nisur për dëgjesa maratonë këto ditë dhe është më gjithëpërfshirëse sesa të marrim një mendim të një individi që nuk është detyruesisht e gjithë bota universitare; e them këtë për të hapur diapazonin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Me të drejtë, siç thotë edhe zoti Ismet, kjo është një përgjigje për kërkesën për ta shtrirë sa më gjerë dhe sa më gjatë diapazonin e konsulencave. Unë mendoj se ia vlen që ne ta bëjmë kërkesën, në mënyrë që ta shterojmë dhe të mos jemi selektivë. Është shumë e rëndësishme që ne të qëndrojmë me orë të gjata dhe të mos jemi selektivë në përcaktimin se kë do të thërrasim sesa të themi se nuk kemi kohë. Sinqerisht, e shikoj shumë të rëndësishme, edhe në përgjigje të sensibilitetit që ka ligji, por edhe në përgjigje të të gjitha shqetësimeve që mund të ketë komunitet apo të gjitha llojet e komuniteteve.

Milva Ekonomi - Jam dakord me ju, sepse është më mirë kështu, meqenëse ligji është bërë shumë sensitiv, u tërhoqëm edhe nga procesi i vendimmarrjes në parim të projektligjit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërkohë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm, kur t'i thërrasim këta njerëz. Ti ishe një nga ato që propozove përkujdesje dhe përkujdesja është që në vend që të thërrasim individë të caktuar, do të thërrasim përfaqësinë e individëve, do të thërrasim shoqatën, do të thërrasim fakultetin ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është edhe e shtuna, edhe e diela.

(Diskutime pa mikrofon.)

Duhet të keni parasysh se do të punojmë edhe ditën shtunë, se kemi punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Cilin draftprogram? Pra, e fillojmë në orën 10:00 dhe derisa të zgjasë, se për të gjitha gjërat e tjera ne nuk biem dot dakord.

(Diskutime pa mikrofon.)

Duhet shkruar raporti, sepse kemi 3 projektligje për të kaluar. Pra, kemi këtë projektligj, kemi projektbuxhetin dhe marrëveshjen për *Fulbright* - in.

(Diskutime pa mikrofon.)

Duhet të përcaktojmë kohën, sepse duhet një relator që do të flasë, prandaj po them që...

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk ka nevojë për dëgjuesë, se flet Almira.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ramë dakord që do ta bëjmë me blloqe nga shoqatat ose nga fakultetet.

Mirela Kumbaro – Pyetja e dytë është që të bëjmë një organizim sa më efikas të kohës. Pra, dita e nesërme është ...

Milva Ekonomi – E kemi të organizuar ditën e nesërme.

Mirela Kumbaro – Vetëm për orën 10:00 dhe 11:00 dëgjova unë. A mund ta shfrytëzojmë edhe pasditen, që të fusim një grup tjetër në orën 13:00 ose 14:00?

Milva Ekonomi – Nuk bëhet, se duhen lajmëruar sot.

Mirela Kumbaro - Këtë po them edhe unë.

Milva Ekonomi – Nuk i lajmëron dot, se nuk janë. Fakultetin duhet ta lajmërosh sot, që ai ta gjejë mundësinë për nesër.

Mirela Kumbaro – Përveç fakultetit.

Milva Ekonomi – Ne thamë se do të shikojmë se kush do të vijë nga shoqatat dhe kush nuk vjen, do ta lajmërojmë, ndërkohë nesër pasdite mund të kalojmë buxhetin nen për nen. Pra, kur të mbarojmë me këtë, do të kalojmë buxhetin nen për nen dhe nuk do të bëjmë dëgjues të tjerë. Dakord?

Mirela Kumbaro – Për këtë duhet dërguar një komunikim në grupin e *whatsapp*-it, me qëllim që kolegët që nuk janë, ta dinë, kështu gjithsecush duhet të organizohet.

Sekretarja - Jua nisa të gjithëve lajmërimin për nesër.

Mirela Kumbaro – E nise me *e-mail*?

Sekretarja - Po, me *e-mail*.

Mirela Kumbaro – Dërgojua edhe në *whatsApp*, që kolegët ta shikojnë.

Sekretarja - Ka ardhur edhe dekreti i Presidentit që ka kthyer ligjin “Për rininë”. Unë kam pyetur nëse do ta fusin apo jo në seancën e ardhshme, por nuk kam marrë ende përgjigje, ndaj, kur ta marr këtë përgjigje, do t’jua komunikoj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Bujar Çela – Jo vetëm të shtunën, siç e thashë në fillim, por edhe të dielën mund ta mbarojmë, se ky ligj nuk vjen më. Unë mendoj që të bëjmë një marrëveshje si kolegë, duke filluar nga unë, nga Ismeti, e të tjerët me radhë, që kur themi dëgjuesë, të dëgjojmë ata dhe ato, jo të flasim ne dhe të harrojmë se për çfarë i kemi thirrur ata.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Shihemi nesër në orën 10:00.

MBYLLET MBLEDHJA